



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 23 (827827)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 9 qershor 2023

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar të stërvitjes "Saber Guardian 23"

Zëvendëseshi i Shtabit të Përgjithshëm të ZFA-së shqiptare, gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar të stërvitjes "Saber Guardian", zhvilluar në Rumani në kuadër të stërvitjes së madhe "Defender Europe 23". Në këtë stërvitje, Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan me një togë të Policisë ushtarake, e atashuar pranë Kompanisë së Policisë Ushtarake Amerikane. Gjatë pritjes në Ditën e Vizitorëve të shquar,

zhvilluar në rajonin stërvitor Bordusani (Ialomitë), gjeneralmajor Shehu e shoqëruar dhe nga atasheu ushtarak i Shqipërisë në Rumani, kolonel Leonard Çoku, u takua me ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Rumanisë z. Angel Tîlvar dhe shefin e Shtabit të Mbrojtjes, gjeneral Daniel Petrescu, të cilët i falënderoi për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, si dhe për pjesëmarrjen e togës së Policisë Ushtarake, si pjesë e kësaj stërvitjeje. Gjithashtu gjenerale

Shehu takoi edhe drejtues të tjerë të lartë, përfaqësues të vendeve pjesëmarrëse në stërvitje. Gjeneralmajor Shehu pati një takim të veçantë edhe me përfaqësuesit e Forcave të Armatosura, efektivin e Policisë Ushtarake, të cilët i falënderoi për disiplinën, korrektësinë, profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar në këtë stërvitje. Stërvitja "Saber Guardian", pjesë e "Defender Europe 23", u zhvillua në Poligonin Smârdan, Bordushani...

» faqe 4



Gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në stërvitjen "Sarex Imponimi 2023"



» faqe 3

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia merr pjesë në ceremoninë "Dita e Vizitorëve të Shquar" të stërvitjes "Defender Europe-23"

Në kuadër të Ditës së Hapur të stërvitjes shumëkombëshe "Defender Europe - 23", komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia ishte i ftuar në "Ditën e Vizitorëve të Shquar", që u zhvillua në Poligonin e Krivollakut, në Maqedoninë e Veriut. Forca Tokësore në këtë aktivitet u përfaqësua nga 122 ushtarakë dhe 25 mjete të blinduara të tipit HMMWV, të cilët në këtë stërvitje treguan angazhim, përkushtim dhe profesionalitet të lartë, duke demonstruar krah për krah me vendet aleatë të NATO-s...



» Faqe 3

Baza Ajrore Farkë zhvillon stërvitjen "Astral Knight"

Në kuadër të stërvitjes "Defender 23", Forca Ajrore mirëpriti efektivin dhe helikopterët e USAF si pjesëmarrës në stërvitjen "Astral Knight". Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte rritja e aftësive operacionale të Forcave Ajrore Shqiptare për të bashkëpunuar me forcat ajrore të vendeve aleate dhe jo vetëm për kryerjen e operacioneve ajrore komplekse si: monitorim/kontroll të hapësirës ajrore, planëzim dhe zhvillim të mbrojtjes ajrore në mënyrë aktive si dhe kryerja e operacioneve të evakuimit të personelit ushtarak, i cili ndodhej në zonat ku zhvilloheshin luftimet...



» Faqe 4

Robotët "vrasës", teknologjia "smart" dhe e drejta ndërkombëtare

Titulli i filmit me metrazh të shkurtër "Slaughterbots" është klikuar më shumë se dy milionë e gjysmë herë nga publikimi i tij në nëntor 2017. Gjithçka duket vetëm 'science fiction', halucinacione të njerëzve të frikësuar. "Në asnjë rast, - mendon Thomas Küchenmeister, që angazhohet për ndalimin e sistemeve të armëve autonome, - hapi deri aty është shumë i vogël". Küchenmeister është kryetar i "Facing Finance", një organizate gjermane, pjesëtare e fushatës ndërkombëtare "Stop Killer Robots". Ai viziton panaire të armëve...



» Faqe 6

SHSHPFA, gjeneral brigade Kingji, takim kortezie me gjeneralmajor John Mead

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një takim kortezie me zv. SHSH të Planifikimit të Komandës së Forcës së Bashkuar Aleate të NATO-s (JFC Napoli), gjeneralmajor John Mead. Gjatë takimit dypalësh u diskutuan mbi Planet Rajonale të Krahut Lindor të Aleancës, rolin e vendit tonë si një faktor dhe promovues i sigurisë dhe qëndrueshmërisë në rajon, si dhe në mbështetjen e vazhdueshme të këtyre planeve.

Gjatë takimit, gjeneralmajor Mead u njoh dhe me proceset e modernizimit të Forcave të Armatosura, të rëndësishme për vetë operacionalitetin e forcave tona, njëkohësisht për të pasur forca dhe struktura të ndërveprueshme dhe mbështetëse në misionet dhe operacionet e NATO-s, në rajon dhe më gjerë. Një vëmendje e veçantë iu kushtua dhe situatës aktuale në veri të Kosovës, mbi rëndësinë që ka KFOR-i në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe mos-përshkallëzimit



të mëtejshëm të konflikteve.

Vizita e gjeneral Mead vijoi më pas në takimin me Komandantët e Forcave kryesore të FARSH-së dhe përfaqësuesit kryesorë të Shtabit të Përgjithshëm, me qëllim prezantimin

dhe njohjen me Planet Rajonale të Mbrojtjes së NATO-s, së bashku me udhëzimet për mënyrën se si vendet anëtare të Aleancës duhet të përmirësojnë logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme për dislokimin e shpejtë



të trupave.

Komanda e Forcës së Bashkuar Aleate e NATO-s në Napoli, është një ndër tre komandat kryesore të strukturës së Aleancës, përgjegjëse për zhvillimin e operacioneve ushtarake

në një spektër të gjerë në Zonën e Përgjegjësisë (përfshirë dhe rajonin tonë) dhe më gjerë. Kjo komandë kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurisë tokësore, detare dhe ajrore të shteteve të NATO-s.

Gjeneral Kingji merr pjesë në aktivitetin e 75-vjetorit të krijimit të Konfederatës Ndërraleate të Oficerëve Rezervë (CIOR)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë (SHKURSH), me rastin e përkujtimit të 75-vjetorit të Konfederatës Ndërraleate të Oficerëve Rezervë. Në këtë aktivitet merrnin pjesë ish-ushtarakë anëtarë të SHKURSH, si dhe drejtues të shoqatave homologe të ushtarakëve në rezervë të Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në fjalën e tij me këtë rast, vlerësoi aktivitetin si një takim brezash dhe miqsh të vlerave të përbashkëta. "Konfederata Ndërraleate e Oficerëve Rezervë është një zë i fuqishëm, që flet dhe mbështet me gjuhën e eksperiencës. CIOR jo vetëm që është zëri i rezervistëve në Aleancën e NATO-s, duke dhënë këshilla strategjike Kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s për çështjet e rezervës, por edhe kontribuon drejtpërdrejt në qëllimet e NATO-s, duke promovuar bashkëpunimin dhe ndërveprueshmërinë midis forcave rezervë brenda Aleancës dhe partnerëve të saj", - theksoi ndër të tjera gjeneral Kingji. CIOR është një organizatë e dedikuar për bashkëpunim



dhe solidaritet ndërmjet shoqatave kombëtare të ushtarakëve rezervë brenda Aleancës Euroatlantike. Konfederata promovon dhe organizon masa të avancuara trajnimi, seminare ndërkombëtare

dhe takime pune për oficerët rezervë. Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë aderon me të drejta të plota në këtë organizatë që prej vitit 2009.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji ka marrë pjesë në ditën përmbyllëse të stërvitjes së përbashkët “Sarex Imponimi 2023”, që u zhvillua në gjirin e Durrësit. Efektivë të Forcës Detare, Rojës Bregdetare, Regjimentit të Operacioneve Speciale, Bazës Ajrore Farkë, Policisë Kufitare, Antikontrabandës, Qendrës së Kërkim-Shpëtimit dhe Kapitanerisë së Portit të Durrësit, për tri ditë rresht testuan kapacitetet e përbashkëta operacionale, si dhe elementët e ndërveprimit nëpërmjet strukturave shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë dhe kanë interesa në det.

Në aktivitetin e zhvilluar me rastin e përfundimit të kësaj stërvitjeje merrnin pjesë gjithashtu komandantët e komandave kryesore, si dhe përfaqësues të pushtetit vendor dhe institucioneve ligj zbatuese në det. Kjo stërvitje synoi koordinimin dhe bashkërendimin e operacioneve të përbashkëta të Forcave Detare dhe të Rojës Bregdetare me institucionet e tjera shtetërore, për zbatimin e ligjshmërisë në det.



Gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në stërvitjen “Sarex Imponimi 2023”



Në kuadër të Ditës së Hapur të stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe – 23”, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia ishte i ftuar në “Ditën e Vizitorëve të Shquar”, që u zhvillua në Poligonin e Krivollakut, në Maqedoninë e Veriut.

Forca Tokësore në këtë aktivitet u përfaqësua nga 122 ushtarakë dhe 25 mjete të blinduara të tipit HMMWV, të cilët në këtë stërvitje treguan angazhim, përkushtim dhe profesionalitet të lartë, duke demonstruar krah për krah me vendet aleatë të NATO-s dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia përgëzoi ushtarakët e Kompanisë III të Batalionit II të Këmbësorisë, të Forcës Tokësore për aftësitë profesionale dhe përfaqësimin dinjitoz, duke treguar edhe njëherë se FARSH është e aftë dhe ka të gjitha kapacitetet e duhura, për konsolidimin e elementëve të gatishmërisë dhe ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave amerikane, vendeve të NATO-s dhe atyre partnere, duke demonstruar aftësinë për të ofruar stabilitet dhe siguri në rajonin e Europës.



Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia merr pjesë në ceremoninë “Dita e Vizitorëve të Shquar” të stërvitjes “Defender Europe-23”



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar të stërvitjes “Saber Guardian 23”

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së shqiptare, gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar të stërvitjes “Saber Guardian”, zhvilluar në Rumani në kuadër të stërvitjes së madhe “Defender Europe 23”.

Në këtë stërvitje, Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan me një togë të Policisë ushtarake, e atashuar pranë Kompanisë së Policisë Ushtarake Amerikane.

Gjatë pritjes në Ditën e Vizitorëve të shquar, zhvilluar në rajonin stërvitor Bordusani (Ialomita), gjeneralmajor Shehu e shoqëruar dhe nga atashëu ushtarak i Shqipërisë në Rumani, kolonel Leonard Çoku, u takua me ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Rumanisë z. Angel Tîlvăr dhe shefin e Shtabit të Mbrojtjes, gjeneral Daniel Petrescu, të cilët i falënderoi për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, si dhe për pjesëmarrjen e togës së Policisë Ushtarake, si pjesë e kësaj stërvitjeje. Gjithashtu gjenerale Shehu takoi edhe drejtues të tjerë të lartë, përfaqësues të vendeve pjesëmarrëse në stërvitje. Gjeneralmajor Shehu pati një takim të veçantë edhe me përfaqësuesit e Forcave të Armatosura, efektivin e Policisë Ushtarake, të cilët i falënderoi për disiplinën, korrektësinë, profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar në këtë stërvitje.

Stërvitja “Saber Guardian”, pjesë e “Defender Europe 23”, u zhvillua në Poligonin Smârdan, Bordushani në Qarkun Galați, ku morën pjesë rreth 10 000 trupa nga 13 vende aleate dhe partnere, Shqipëria, Bullgaria, Italia, Franca, Greqia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Polonia, Portugalia dhe Holanda. Moldavia u përfaqësua nga një detashment ushtarak në Brigadën së Këmbësorisë së Mekanizuar.

“Saber Guardian” ishte stërvitja më e madhe ushtarake e planifikuar në Rumani këtë vit, dhe është Ushtrimi i tretë dhe i fundit i lidhur me “Defender Europe 23”, pjesë e angazhimit dinamik të parandalimit të NATO-s në 2023. Të udhëhequr nga Ushtria e SHBA-së në Evropë dhe një divizion shumëkombësh rumun, aktivitetet e “Saber Guardian” përfshinë përdorimin e pajisjeve të paracaktuara, një marshim taktik rrugor, kalime lumore, manovra për t’iu përgjigjur kërcënimeve të simuluar kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore dhe op-



eracionet e evakuimit mjekësor.

Në territorin e Rumanisë, stërvitja “Saber Guardian” zgjati nga data 27 maj deri më 9 qershor dhe u drejtua nga Komanda e Forcave të Përbashkëta, duke përfaqësuar aktivitetin më të madh dhe më kompleks stërvitor shumëkom-

bësh këtë vit në territorin e Rumanisë.

Stërvitja shumëkombëshe “Saber Guardian 23” vazhdon serinë dyvjeçare në kuadër të “Defender Europe 23” dhe synimi kryesor është të rrisë ndërveprueshmërinë në një gamë të gjerë misionesh për forcat nga NATO dhe



shtetet partnere. Aktivitetet stërvitore përfshijnë veprime taktike në tokë, forcimin e rrjedhave ujore, ushtrime taktike me dhe pa gjuajtje luftarake me tekniken e të gjitha kategorive të forcave, parashutat, si dhe aktivitetet e evakuimit dhe trajtimit të të plagosurve.

Sekuencat kryesore të stërvitjes u zhvilluan në Qendrën Kombëtare të Stërvitjes për Betejat “Getica” në Cincu (Brasov), në qendrat sekondare të stërvitjes luftarake në Smârdan (Galați) dhe Babadag (Tulcea), në qitje tokëajër, poligon i Shkollës së Trajnimit të Mbrojtjes Kundërajrore “Gjeneral Ion Bungescu” (Capu Midia) dhe në bazën e 57-të ajrore “Mihail Kogălniceanu” (Constanta).

Në të njëjtën kohë, ngjarjet praktike të “Saber Guardian 23” u zhvilluan në rajonin e trajnimit në Slobozia dhe Bordusani (Ialomita), Vărsătura (Brăila) dhe Frecăței (Tulcea).

Shtetet pjesëmarrëse me personel dhe pajisje luftarake në “Saber Guardian

23” ishin: Shqipëria, Bullgaria, Franca, Greqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Polonia, Portugalia, Moldavia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Holanda dhe Rumania. Duke filluar nga ky vit, në kuadër të “Saber Guardian 23” u prezantua një komponent trajnimit në fushën e mbrojtjes kibernetike “CYBER”, në të cilin marrin pjesë specialistë nga Rumania, SHBA-të dhe Mali i Zi. “Saber Guardian 23”, një kulm i formimit profesional, ishte e integruar në kompleksin e ushtrimeve “Defender 23” dhe përfshiu fazat e planifikimit dhe organizimit, të nisura përpara atyre të ekzekutimit operacional, që u zhvilluan aktualisht. Stërvitjes i ka paraprirë, gjatë muajit maj, faza e fluksit të personelit dhe pajisjeve në rrugët e komunikimit rrugor, detar dhe ajror nga vendet, drejt zonave të stërvitjes dhe u pasua nga faza e përqendrimit të forcave në qershor.

Komanda e Forcave të Bashkuara “Gjeneral Ioan-Emanoil Florescu” ushtroi komandën dhe kontrollin mbi strukturat pjesëmarrëse në “Saber Guardian 23”.

Në Qendrën Stërvitore Pashaliman përfundoi Kursi i Avancuar i Nënoficerit

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Avancuar të Nënoficerit.

Gjatë kësaj periudhe kursantët kanë ndjekur programin teorik dhe praktikë mësimore.

Nga kursantët është treguar disiplinë e lartë dhe korrektësi në zbatimin e rregulloreve bazë të Forcave të Armatosura. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin e kursit.



Seksioni i Stërvitjes në Policinë Ushtarake mbylli me sukses Kursin e Avancuar të Nënoficerit, në specialitetin Polici Ushtarake, me një kohëzgjatje prej 8 javësh.

Kursi kishte si mision marrjen e njohurive themelore mbi parimet dhe veprimtarinë për të zbatuar të gjitha detyrat në operacione që kryen Policia Ushtarake si nga ana individuale, por edhe në përbërje të skuadrës dhe togës.



Baza Ajrore Farkë zhvillon stërvitjen “Astral Knight”

Në kuadër të stërvitjes “Defender 23”, Forca Ajrore mirëpriti efektivin dhe helikopterët e USAF si pjesëmarrës në stërvitjen “Astral Knight”.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte rritja e aftësive operacionale të Forcave Ajrore Shqiptare për të bashkëvepruar me forcat ajrore të vendeve aleate dhe jo vetëm për kryerjen e operacioneve ajrore komplekse si: monitorim/kontroll të hapësirës ajrore, planëzim dhe zhvillim të mbrojtjes ajrore në mënyrë aktive si dhe kryerja e operacioneve të evakuimit të personelit ushtarak, i cili ndodhet në zonat ku zhvilloheshin luftimet (Combat Search and Rescue), veçanërisht ekuipazheve fluturuese të dëmtuara/rrëzuara në zonën e luftimit.

Ekuipazhet fluturuese të të dyja vendeve (USAF të dislokuar në Bazën Ajrore Farkë dhe Skuadronin Operacional të Helikopterëve “AS532AL Cougar” të BAF), zhvilluan fluturime kompaktësuese me fokus, rikonicionin e zonave ku u zhvillua stërvitja.

Zhvillimi i kësaj stërvitjeje kishte një rëndësi të veçantë për Forcat Ajrore shqiptare pasi u zhvillua ditën dhe natën, si në tokë ashtu edhe në det, e cila tregoi edhe një herë objektivin tonë për përmbushjen sa më mirë të angazhimeve që Forcat e Armatosura Shqiptare kanë në kuadër të mbrojtjes kolektive.



Specialistët EOD, në ndihmë të banorëve të fshatit Shargë, Vorë

Gjatë punimeve në terren të një kompanie private, në zonën e fshatit Shargë, bashkia Vorë, u konstatuan municione të pa plasura.

Pas njoftimit, grupi i specialistëve EOD të Batalionit të Xhenios, shkoi në vend dhe në masa të larta sigurie bëri të mundur zbulimin, grumbullimin dhe magazinimin e 13 municioneve artilerie të paplasura.

Municionet u transportuan sipas rregullave në depon e municionit të Batalionit të Xhenios. Operacioni përfundoi me sukses.



*Me moton:
“Kush dhuron gjak, shpëton jetë dhe përmirëson shëndetin”,
pas një fushate sensibilizuese,
32 efektivë të QAPU-së dhuruan gjak për njerëzit në nevojë.*



Xhenierët rehabilitojnë vendin e pelegrinazhit të fesë bektashiane kthyer në tunel

Specialistët e batalionit të xhenios në Komandën Mbështetëse përfunduan brenda afatit operacionin për rehabilitimin e shpellës së pelegrinazhit në teqenë e Ballëm Sulltanit në fshatin Ballenjë, njësi administrative Martanesh. Kjo shpellë, vend pelegrinazhi për besimtarët bektashianë, ishte tjetërsuar në një tunel. 14 efektivë xhenierë, për më se 20 ditë punuan për rehabilitimin e shpellës duke prishur muret e tunelit me gjatësi 25 m, lëvizur 97m³ inerte, 7.3 ton hekur, përdorur 30 kg lëndë plasëse dhe hapjen e 2755 furnelave për vendosjen e saj. Objekti tip tunel u shkatërrua me shpërthim të kontrolluar me seksione çdo tre metra dhe prishje të strukturës beton arme me matrapik dhe transport inertesh jashtë tunelit me krahë. U zhvilluan plasje të kontrolluara për një javë, duke kryer 2 plasje në ditë dhe prerje me ngarkesa të zgjatura të soletës së tunelit.

Këtij vendi të shenjtë për fenë bektashiane iu shtua dhe shpella, ku besimtarët kryejnë ritet e tyre fetare. Më datën 29 qershor besimtarët bektashianë të mbarë vendit do të kryejnë pelegrinazhin e tyre në objektin e kthyer ashtu si ka qenë ndër vite dhe kjo falë punës dhe përkushtimit të xhenierëve tanë.






KOLONEL HYSNI GJERGJI

Titulli i filmit me metrazh të shkurtër “Slaughterbots” është klikuar më shumë se dy milionë e gjysmë herë nga publikimi i tij në nëntor 2017. Gjithçka duket vetëm ‘science fiction’, halucinacione të njerëzve të frikësuar. “Në asnjë rast, - mendon Thomas Küchenmeister, që angazhohet për ndalimin e sistemeve të armëve autonome, - hapi deri aty është shumë i vogël”. Küchenmeister është kryetar i “Facing Finance”, një organizate gjermane, pjesëtare e fushatës ndërkombëtare “Stop Killer Robots”. Ai viziton panaire të armëve dhe bisedon me prodhuesit e tyre. Armë me një autonomi të caktuar ka edhe sot, për shembull raketat që kërkojnë në mënyrë të pavarur objektivat e mundshme dhe vendosin vetë, se cilin mund të shkatërronin. Kryesisht ato komandohehen nga njerëzit, por për sulmin konkret nuk ka ushtarë që jep urdhrin, shpesh ai as nuk mund ta ndalë raketën.

Autonomia e armëve vrasëse mbart implikime dhe ndikime delikate në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Në qendër të debatit me “të mirat” dhe “të këqijat” e LAWS (Lethal Autonomous Weapons Systems), janë pasojat të cilat lidhen kryesisht me vendimmarrjen, nëse dhënia e të drejtës për të eliminuar automatikisht një objekt, e përçmon jetën e njeriut. Një hap cilësor por i debatueshëm dhe delikat, në fushën e teknologjisë ushtarake, është sistemi luftarak vetë-veprues i asgjësimit të kundërshtarit me zjarr. Këto janë sistemet (LAWS), të njohura si “robotët vrasës”, si kategori e veçantë e sistemeve të armëve që përdorin grupe sensorësh dhe algoritme kompjuterike për të identifikuar, ndjekur dhe asgjësuar një objekt, pa kontroll njerëzor të sistemit. Në varësi të ndërtimit të sistemit, LAWS mund të arrijë të zëvendësojë në mënyrë praktike luftëtarët, duke eliminuar nevojën për dislokime njerëzore në zona me rrezik dhe kushte të vështira për jetën e njeriut. “Bekimi” i LAWS qëndron gjithashtu edhe në faktin se ai ul ndjeshëm rrezikun për jetët e ushtarëve tanë, pa e ulur aftësitë luftarake, si dhe e shmang debatin politik për strategjitë afatgjata, pasi liderët heqin dorë nga lufta vetëm për shkak të viktimitave njerëzore. Ndryshe nga disa shtete të tjera të NATO-s, përkufizimi i SHBA-së për armët autonome specifikon përfshirjen e LAWS, por të mbikëqyrur nga njeriu.

Shtetet e Bashkuara kanë përdorur prej kohësh sisteme pa pilot për të shënjestruar anëtarët e organizatave ndërkombëtare terroriste, ku një operator njerëzor ka dhënë gjithmonë urdhrin për të vrarë. Ky është një sistem i krijuar për t’u siguruar njerëzve mundësinë që të ndërpresin funksionimin e armëve, gjatë dhe pas aktivizimit, nëse vlerësohet gabim kjo shënjestër. Përfitimet dhe rreziqet e mundshme të përdorimit të LAWS, duhet të analizohen me kujdes, duke vlerësuar efektet dhe defektet që rrjedhin nga ky evolucion. Pa një kornizë ligjore mbikëqyrëse për armët autonome, rrezikohet një përgjigje e vonuar dhe e ngjashme me atë që ndodhi pas përdorimit të bombës së parë atomike. Përfitimet gjatë automatizimit të armëve vdekjeprurëse në fushën e luftimit, janë edhe më të mëdha. Për shkak të mungesës së emocioneve njerëzore negative që lidhen me ankthin, frikën, lodhjen, përfitimin personal, kushtet shëndetësore etj., IA-ja (Inteligjenca Artificiale) mund të bëjë zgjedhje objektive në kohë krize, të cilat do të shpëtojnë jetë njerëzish. Kompjuterët e LAWS nuk i nënshtrohen të njëjtave kufizime si njerëzit, që është aftësia për të operuar në mjedise luftarake për periudha të gjata kohore, pa nevojën për furnizim, ushqim, logjistikë etj., deri në përfundimin e operacionit, zbatimi i LAWS paraqet disa “sfida” mbrojtjeje dhe sigurie të vetë sistemit, të tilla si hakerimi i sistemit, nëse ky sistem përdor

Robotët “vrasës”, teknologjia “smart” dhe drejta ndërkombëtare



aplikacione të IA-së. Një nga sfidat e sistemeve LAWS është fakti se gabimet njerëzore zakonisht i adresohen një individi të vetëm, ndërsa gabimet në sistemet komplekse të IA-së, rrezikojnë dështim të përgjithshëm të sistemit teknologjik ‘smart’.

Reagimet ndërkombëtare ndaj LAWS sot janë kontradiktore, por e marrin parasysh “bekimin” dhe “mallkimin”, që vjen nga kjo armë, e cila akoma është në hapat e para dhe e pa zhvilluar plotësisht. Disa shtete përdorin armë gjysmë autonome, ku njeriu ka të drejtë të ndërhyjë dhe ndërpresë ekzekutimin e sulmit. Makinat nuk e kuptojnë se çfarë do të thotë të vrasësh një qenie njerëzor. Një nga avantazhet më të mëdha të LAWS, domethënë mungesa e emocioneve të tyre, është gjithashtu një e metë qendrore. Paaftësia e një roboti për të reflektuar mbi veprimet e tij, ose për të kuptuar vlerën e jetës së një individi, në thelb i kthen njerëzit e synuar në objekte. Nëse një kompjuter kryen një veprim të paligjshëm në luftim do të ishte e pamundur të ndëshkohej. Presioni nga OJQ-të do të përballte LAWS, pasi Konventa për Armët Konvencionale, ende nuk ka publikuar rekomandim specifik të politikave për shtetet anëtare në lidhje me kufizimin e tyre. Pavarësisht nëse arrihet një marrëveshje ndërkombëtare që kufizon LAWS, është thelbësor një plan emergjence kundër një teknologjie të tillë të përdorur nga kundërshtarët e NATO-s.

Shumë përdorues të teknologjisë ‘smart’ edhe në forcat e armatosura, posedojnë celularë të gjeneratave të fundit vetëm për komunikim dhe argëtim pa ditur shumë funksione të tjera të tij. Shumë kush nuk di që në celularin e tij mbart një telekomandë që aktivizon një pajisje tjetër, një regjistruar të sofistikuar, transmetues të dhënash, madje edhe një armë apo “person tjetër” që ka hyrë në jetën e tij, jeton në të njëjtën shtëpi me të, madje fle në të njëjtën dhomë me të. Duhet të dimë se çdo e dhënë e jona personale që kemi sot në ‘Facebook’ apo androidin tonë, janë të cenueshme dhe hakerat privatë dhe shtetërorë, do të përpiqen t’i vjedhin dhe përdorin për qëllime dashakeqëse. Shtetet autoritare dhe totalitare, të pasigurt mbi fuqinë e tyre të vërtetë, kanë luftuar gjithmonë intimitetin, me rrjetet e policisë sekrete, siç bëjnë

vendet demokratike në luftë apo në kohëra trazirash. Po kalohet në një epokë të mbikëqyrjes së vazhdueshme, por tashmë jo nga policia sekrete, por nga reklamuesit dhe ndërmarrjet tregtare.

Duke poseduar një smartphone, ne rrezikohemi nga një “armë” madje po humbasim edhe disa “gjendje” për të cilat njeriu është investuar në shekuj, si privatësia. Kjo gjendje e të qëndruarit vetëm, pa u ndikuar, shikuar, vëzhguar, shqetësuar, bezdisur apo dëgjuar nga të tjerët, pa dijeninë dhe miratimin e tij. Kompanitë më të pasura në botë, gjenerojnë pasuri duke vendosur sa më shumë gjurmues, dhe kamera brenda ambienteve të jetesës, dhe sa më afër vendbanimeve tona. ‘Huawei’ kinez është gjigandi kinez i celularëve, që përdor përparësinë teknologjike për spiunazh politik, ushtarak apo tregtar në të gjithë hapësirën ku ai është i shitur. Ky aplikacion është kthyer në



armë të shtetit kinez, pasi sistemi autoritar atje kontrollon çdo gjë, monitoron çdo sipërmarrje private dhe si përfundim e përdor atë. Një aparat celulari ‘Huawei’ vlerësohet të jetë një “marrës” të dhënash dhe transferimi i tyre tek porositësit, bëhet pa dijeninë apo pa asnjë informacion paralajmërues për klientin nga kjo kompani. Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera perëndimore kanë shprehur shqetësim se Qeveria e Kinës, mund ta përdorë teknologjinë e ‘Huawei-t’ për të rritur

kapacitetet e saj të spiunazhit, sepse sipas legjislacionit kinez, çdo kompani ka kontroll, detyrim dhe mbikëqyrje shtetërore.

Në nëntor 2022, ‘TikTok’, pranoi se punonjësit e kompanisë në Kinë, mund të kenë akses në të dhënat e përdoruesve europianë. SHBA-të e kanë ndaluar gjithashtu edhe aplikacionin ‘TikTok’ në telefonat celularë zyrtarë, i cili ka rreth një miliard përdorues në mbarë botën. Pas SHBA-së, komisioni i BE-së u ndaloj punonjësve të tij të përdorin aplikacionin ‘TikTok’ në telefonat celularë ose laptopët e punës. Arsyeja e vendimit është mbrojtja e të dhënave dhe shqetësimi për aksesin e shtetit kinez në kompaninë ‘TikTok’.

Luftën në hapësirën kibernetike, po e zhvillojnë edhe shtetet jo demokratike dhe kundërshtarë me vendin tonë, të tilla si Kina, Rusia, Koreja e Veriut si dhe Irani. Sulmet kibernetike si alarme për bomba në shkollë në Maqedoninë e Veriut, janë bërë shumë shqetësuese nga tetori i vështirë.

Integrimi i inteligjencës artificiale në NATO kërkon një përpjekje të përbashkët të aleatëve për të standardizuar teknologjitë, në sektorin publik dhe privat, për të përmirësuar inovacionin dhe zhvilluar arsimin. Aleanca duhet të shfrytëzojë konkurset e teknologjisë, për të nxitur teknologjitë, me sipërmarrësit, drejtuesit e industrisë private, qeverisjes dhe akademive, të cilët do t’u mundësonin si shteteve ashtu dhe shkencëtarëve privatë të bashkëpunojnë. LAWS paralajmëron se shtetet autoritare, mund t’i zhvillojnë në mënyrë indirekte mjetet autonome vdekjeprurëse, duke e fshehur qëllimin e vërtetë nën avancimin e AI-së tek pajisjet civile. Vendimi i NATO-s për të ecur përpara me zhvillimin e AI-së dhe sistemeve autonome të armëve, kërkon një ndryshim të plotë organizativ dhe etik midis vendeve anëtare. “Ka tre vdekje tashmë të njeriut, kur vdes truri, vdes zemra dhe kur është jashtë rrjetit”. Rrjetet sociale shfrytëzojnë padijen, dobësinë dhe vartësinë njerëzore, duke projektuar dhe pasur në mendje gjithmonë një përfitim.

Zhvillimi i vrullshëm dhe i pa kontrolluar për arsye fitimi i medias sociale, ka zhvilluar edhe një “negativitet” tjetër të teknologjisë të ashtuquajtur “dilema Sociale”. A është produkti që ne marrim falas nga rrjetet sociale, një gjë e mirë apo e keqe? Në kapitalizëm gjithçka paguhet dhe nëse ne nuk paguajmë për produktin, atëherë është e qartë se ne jemi vetë produkti. Kjo është industria e blerjes “falas” së vëmendjes. Kjo industri e re ka nevojë për njerëz të shpërqendruar, dhe të hapur ndaj reklamave që në median sociale janë shndërruar në epidemi. Rusia e përdori këtë fenomen në zgjedhjet e vitit 2016, duke arritur të shpërqendrojë opinionin amerikan lidhur me kandidaturat për president mes Clinton dhe Trump.

Në tema afatgjatë, ky fenomen së bashku edhe me faktorë të tjerë, ka çuar në një epidemi të ashtuquajtur “sëmundje të shpërqendrimit”. Ne i mendojmë platformat tona të mediave sociale, thjesht një mjet për të mbajtur kontakte me miqtë dhe familjen tonë. Po këto platforma, nuk janë thjesht mjete, pasi po të ishin të tilla, ato nuk do na njoftonin, shqetësonin, joshnin dhe manipulonin, duke dërguar një lumë me njoftime dhe e-mail-e, të cilat kanë objektiv të blejnë falas, kohën tonë, vëmendjen tonë dhe përfundimisht vendimin tonë.

NGA KOLANA "SKËNDERBEGASIT NDËR VITE"

Shahin Leka, Profesor i Historisë së Artit Ushtarak

Shahin Mahmut Leka u lind më 2 tetor të vitit 1934 në Delvinë. Në vitet 1940-1950 kryen arsimin fillor në Sarandë dhe në Tiranë. Në vitet 1950-1951 mbaron vitin e parë të gjimnazit në shkollën "Qemal Stafa" në Tiranë. Në vitin 1951 shkon në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", të cilën e përfundon me rezultate shumë të mira. Më pas përfundon me rezultate të shkëlqyera kursin e gjuhës angleze në Shkollën e Bashkuar të Officerëve në Tiranë dhe gradohet nëntoger. Në vitet 1954-1955 kryen kursin plotësues në Shkollën e Bashkuar të Officerëve. Në vitet 1964 deri në vitin 1966, përfundon Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm dhe merr gradën e 'kapitenit'.

Paralelisht dhe përkatesisht në vitet 1958-1962, Shahin Leka përfundon me korrespondencë dhe Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës.

Karriera

Titullohet oficer me gradën nëntoger dhe më tej vazhdon karrierën si Shef i Zbulimit i batalionit autonom të Ersekës, komandant i Grupit të Zbulimit në Detashmentin e Zbulimit në Tiranë, komandant kompanie në Shkollën Ushtarake "Skënderbej, student në Akademinë Ushtarake me gradën 'kapiten i parë', pedagog i ushtrive të huaja në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, pedagog i Historisë së Artit Ushtarak në këtë Akademi, del në pension me gradën 'kolonel' në detyrën e shefit të Katedrës së Historisë së Artit Ushtarak.

Për gati 20 vjet rresht, Shahin Leka ka qenë anëtar i kolegjiut të revistës ushtarake "Për Mbrojtjen e Atdheut"; pedagog i jashtëm për shumë vite akademike, pjesëmarrës i shumë sesioneve shkencore në nivel ushtrie e Akademie; pjesëmarrës aktiv me referate e kumtesa shkencore në disa konferenca shkencore si në Greqi, Rumani, Marok etj.; anëtar i Këshillit Shkencor; kryetar i Shoqatës së Historianëve Ushtarakë të Shqipërisë, etj... Shahin Leka, në vitin 1995 fiton gradën shkencore "Kandidat i Shkencave"; në vitin 1997 fiton titullin akademik "Docent"; në vitin 1993 "Doktor i Shkencave" dhe në vitin



1995 fiton titullin akademik 'Profesor'.

Zotëron gjuhët e huaja anglisht, serbokroatisht, rusisht dhe italisht.

Veprimtari botuese:

- "Historia e Artit Ushtarak Botëror" (Bashkautor), "Historia e Artit Ushtarak të LANÇ të popullit shqiptar" (bashkautor), "Skënderbeu, strateg dhe komandant legjendar", "Historia e Artit Ushtarak Shqiptar nga lashtësia deri në

vitin 1939" (bashkautor), "Çështje të strategjisë Ushtarake" (bashkautor), "Lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut" (studim), "Mësime të nxjerra nga Lufta e Vlorës-1920", cikël leksionesh, metodikash të zbulimit e ushtrive të huaja, mbi 2900 faqe.

- Mbi 30 referate shkencore, 50 artikuj studimorë, 100 artikuj publicistike, bashkautor në "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar", botime

të karakterit enciklopedik të Qendrës Ndërkombëtare të Kembrixhit dhe të Institutit Amerikan të Biografive. Shahin Leka mban disa urdhra e medalje të akorduara nga Kuvendi popullor, ndërsa me VKM, datë 15.11.1989, iu dha "Çmimi i Republikës i Shkallës së Dytë" për përgatitjen me cilësi të librit "Historia e Artit Ushtarak të LANÇ-it". Doli në rezervë me gradën 'kolonel'.

IN MEMORIUM

Hasan Çipuri, skënderbegasi i talentuar, një nga linguistët dhe studiuesit e njohur të Shqipërisë, me kontribut të dukshëm në fushën sociale, në atë të ushtrisë, të përkthimeve e disa drejtime të tjera.

Hasan Çipuri u lind më 10 shtator të vitit 1935, në Tiranë.

Ai është autor i shumë veprave, ku mes të cilave mund të përmendim: "Fjalori serbisht-shqip", "Çlirimtarët shqiptarë nga Dibra në Zagreb", "Fjalor shumëgjuhësh për fëmijë", "Bilbili dhe trëndafili", "Fjalor i termave ushtarakë të NATO-s", "Gjuha jonë", - disa vëllime, "Studime filologjike", - disa vëllime, "Fjalori enciklopedik shqiptar", nga N - tek Zh, "Mesazhe paqe-Misioni ushtarak holandez në Shqipëri", "Fjalori i shqipes së sotme" me 35 000 fjalë (Bashkautor), "Fjalori i shkurtesave dhe i akronimeve të NATO-s", dhe dhjetëra libra e studime të tjera në shqip e gjuhë të huaja.... Një ndër veprat e plota dhe e mirëpritur nga qarqet shkencore brenda e jashtë Shqipërisë është "Fjalori serbisht-shqip". Ai ka rreth 45 mijë fjalë, 25 mijë shprehje e frazeologjizma, një përcaktim të përpiktë të fushave të përdorimit të fjalëve, i përdorshëm

Prof. Hasan Çipuri, linguisti, shkencëtari ushtarak dhe studiuesi i njohur

nga kushdo në shkollë, në institucionet zyrtare, në jetën e përditshme si dhe me shpjegime gramatikore të hollësishme.

Ja çfarë shkruan për Çipurin, prof. dr. Thoma Çomora: "Hasan Ymer Çipuri, shqiptar nga Peshkopia. Është gjeni në planetin tokë... Diell i argjenditë në qiellin e jetës shqiptare. Gjenerali i vërtetë. E ka nisur shkollën ushtarake 13 vjeç! Dhe kudo me medalje ari. Dhe kudo ka kaluar dy klasë në një vit! Dhe Fakultetin Filologjik e ka mbaruar në 3 vjet e gjysmë! Në një kohë që korrespondenca ishte 6 vjet. Everest që shkrep rrufenë, diamante mbi pergamenë! Ka nisur mësimet më 1946 dhe studimet pasuniversitare më 1986... Zotëruet i 5 gjuhëve të huaja me diploma e dëshmi të rregullta. Unë s'kam njohur njeri të tillë deri më sot! Me 350 punime diturore, me 32 500 faqe shtypi shkencor e publicistikë. Me gjithë këto vepra shkencore të botuara! Dok-

tor e Profesor shkencash me tituj nderi në Europë e Amerikë! Me medalje të artë, Medalje botërore e Lirisë, Medalja e Ambasadorëve Ndërkombëtare dhënë nga Instituti Biografik Amerikan... Gjenerali i lindur në Peshkopi, Dibër, me veprime të paracaktuara, me një shpirt të madh, me talent të lindur, me një punë titanike, me një durim shenjtori. Ky Doktor i madh. Ky Profesor i madh. Ky sfidant i madh. Të ketë pirë një tas me lot, me zemrën e fryrë nga inatet, zilitë e rrufetë e pushtetit totalitar për gati 50 vjet, të gjuhet me rrufe e ky t'i kthejë si të ishin tullumbace?! T'i japë fletë lavdërimi në Pallat të Brigadave vetë Enver Hoxha e më pas Haxhi Lleshi në Peshkopi me motivacionet më të larta e më pas të gremiset në baltën e kuqe të Burrelit, në Shkodër, më pas, shef kuadri e në Sazan pas 6 muajsh, ku qëndroi plot 7 vjet e ndoshta do të kishte vdekur atje sikur të mos kishte dalë B.B (ish-titullar i ministrisë), tiranas zemërbardhë, i cili pasi dëgjoi



ankesat e Profesorit urdhëroi menjëherë të fillonte punë në Ministrinë e Mbrojtjes. Doktor Profesor Hasani nën avujt e çajit, mori pendën dhe bëri ato kryevepra, siç bëjnë shtrëngatat duke derdhur lot të tjerë... E shoh me sytë e mendjes: në shtatëvjeçaren "Demir Gashi", në Akademinë Ushtarake në Fakultetin e Histori-Filogjisë, në

studimet pasuniversitare e më pas në seminare e kurse në Bruksel, në Napoli, në Dubrovnik. Nuk është i vetmi Doktor Profesor Hasan Çipuri, po krejt i veçantë! I ka bërë dhe i bën nder kombit të vet. I thjeshtë dhe i palodhur. 52 vjet punë, doli në pension në 2007 me gradën kolonel ...".

Gruaja shqiptare, luftëtarja e paepur e vlerave njerëzore

Historia e grave suljote ka hyrë në analet e historisë. Aq sa në mendjen e çdo shqiptari është veshur me petkun e legjendës. Gra që për të mos rënë në dorë të turqve u hodhën nga shkëmbi, sepse donin të ishin të lira.

Po a ishte i vërtetë ky si fakt apo historia e shekujve e ka mitizuar dhe këtë ndodhi?

Kërkshërisë mbi këtë fakt i vjen në ndihmë prof. dr. Irakli Koçollari. Pikërisht në fushatën e tretë të Aliut që zgjati rreth një vit, në beteja tepër të vështira, në një terren ku kalonin vetëm dhitë dhe suljotet, ato gjenden të rrethuara në Manastirin e Zalonges.

Aliu arriti të rrethojë gratë e Sulit, të cilat për të mos u bërë robinja të tij, nuk pranuan të dorëzoheshin dhe u hodhën nga shkëmbi.

Është interesante, të hysh në psikologjinë e grave të Sulit

Ato ishin luftëtare me nam dhe shumë trime. Merrnin pjesë në beteja dhe ndihmonin burrat e tyre në luftë, duke hedhur shkëmbinjtë të mëdhenj mbi forcat e Ali Pashait.

Një krahinë që prej 300 vjetësh ishte e lirë dhe udhëhiqej nga Venomet e Jugut patjetër që do ushqente që në deje një liri të pakufizuar dhe gratë do ishin pararojë në familje dhe në fshatrat e Sulit. Por historitë e kësaj krahine që ka marrë petkun e legjendës do visheshin dhe me histori të tjera trimëreshash të ngjashme. Po gra të tjera suljote, gjatë rrethimit të gjatë do të mbylleshin në manastir dhe do të preferonin të digjeshin nga baruti brenda në manastir, se të dorëzoheshin. Dhe ashtu bënë. U dogjën të gjalla për të mos u bërë robinja të Ali Pashait. Gratë suljote, të shquara për trimërinë e tyre do bëheshin objekt edhe në gazetën prestigjioze “New York Times”, shumë vjet më vonë përshkruhet dhe trimëria e këtyre grave me nam në gjithë botën.

Artikulli quhej “Gra të guximshme” dhe bënte fjalë për gratë e Sulit dhe trimërinë e tyre gjatë rrethimit të Ali Pashë Tepelenës.

Në një nga betejat e ashpra të vitit 1792, kur Suli u sulmua nga forca të shumta të Ali Pashës, disa gra suljote, duke parë rrezikun që i kërcënonte armiku i tyre, rrëmbyen armët. Ajo që i printe suljotët ishte Moskoja, gruaja e Kapedan Xhavelles. Gruaja suljote, ashtu si të gjitha gratë shqiptare, i jepnin rëndësi të madhe nocionit “nder”. Në emër të tij, ato ishin gati të sakrifikonin edhe jetën e tyre. “Këto veti të larta të gruas shqiptare, - thotë studiuesi arvanitas, Aristidh Kola, - janë gjëra të panjohura për lindorët, prandaj edhe nuk i çmonin këto veti të larta të shqiptarëve”. Brigjet e Aspropotamit dhe shpatet e thepisura të humnerës së Zallongut, u bënë dëshmitarë të vetë-sakrificës. Gratë suljote preferuan vetëflijimin e tyre. Ato zgjedhën më mirë një vdekje të ndershme, që të shpëtonin nga një jetë prej skllaveje, që i priste, po të binin në



GRATË SULJOTE, TË SHQUARA PËR TRIMËRINË E TYRE DO BËHESHIN OBJEKT EDHE NË GAZETAT E HUAJA. NË NJË PREJ ARTIKUJVE TË GAZETËS PRESTIGJIOZE “NEW YORK TIMES”, SHUMË VJET MË VONË PËRSHKRUHET DHE TRIMËRIA E KËTYRE GRAVE ME NAM NË GJITHË BOTËN.

duart e forcave të Ali Pashës.

Është i njohur tashmë akti heroik i dramës së grave suljote në Zallong. Më shumë se 100 gra, nëna, duke shtrënguar në gji fëmijët e tyre e të pasuara nga vajzat e tyre, u hodhën në humnerën e thepisur të shkëmbinjve të Zallongut.

Ato morën një vendim të shpejtë për t'u mbrojtur nga poshtërimi, turpi dhe tortura. U kapën dorë për dore dhe mbi sheshin e shkëmbit, ku ndodheshin, filluan të hedhin “vallen e vdekjes” së tyre, të cilën e frymëzonte një heroizëm i jashtëzakonshëm e i paparë, kurse tmerret e vdekjes tragjike të tyre përjetonin ritmin. Vallen e shoqëronte kënga patriotike, refrenin e të cilës patjetër e dëgjonte edhe qielli, e dëgjonin edhe shkrepët e Zallongut. Në fund të refrenit, të 100 gratë lëshuan një klithmë rrëqethëse e të gjatë, jehona e të cilës vazhdoi deri në fund të humnerës, ku përfunduan bashkë me krijesat e tyre, që e shtrëngonte fort në gjokset e përgjakura.

Gratë suljote, luftëtare si burrat

Krahas bukurisë, si dhuratë e natyrës, trimëria e gruas çame ka qenë dhe ka zënë vend në kufijtë e legjendës. Rrëfimet e transmetuara brezave, gojëdhënat, këngët, por dhe dokumentet arkivore të kohës, e evidentojnë dëndur këtë fakt. Shumë studiues, që i kanë pasur në qendër të studimit të tyre Çamërinë dhe çamët, e pasqyrojnë gruan çame të Sulit si luftëtare dhe bashkëshorte të aftë të burrit, si bartëse të ideve më të mira të kombit e pajisur me ndjenja të larta si një nënë e denjë për të rritur dhe edukuar fëmijët, si luftëtare e trimëreshë, si shtëpiake e përkryer dhe në punët jashtë shtëpisë, si dhe në mbrojtjen e trojeve, të fisit dhe të afërmeve të saj. “Gratë suljote, - tregon Sukoja, - i pasuan burrat me dyfekun mbi supet, shpatën ngjeshur, koburen dhe gjerdanin; ato inkurajuan trimat dhe i shoqëruan në të gjitha ndeshjet”. Dëshmi

interesante të trimërisë së grave çame sjell dhe Dora D'Istria: “Në rreziqet e mëdha s'ka pasur asnjëherë nën armë më shumë se 1500 luftëtarë. Gratë e tyre i shoqëronin ata në luftë, transportonin ushqime dhe municione dhe në rast nevojë rrëmbejnë dhe pushkën dhe e përdornin atë me mjeshtëri, si burrat e djemtë e tyre. Sali Pasha, i biri i Aliut, që ishte poet, i ngre lart vlerat e grave suljote në një vjershë të tij, duke vënë në gojën e Ali Pashës vargjet: “...Shihni si qëndrojnë suljotët/ Trima burrat, burrëresha gratë...”,

Shembulli dhe heroizmi i grave suljote u jepte kurajë jo vetëm luftëtarëve suljotë, por edhe indiferentëve dhe frikacakëve. Ato i ndiqnin hap pas hapi burrat dhe djemtë e tyre. Thuhet, se Moskoja, gruaja e kapedan Xhavelles, kur kishte arritur në kullën e Qafës në Sul, gjeti të shtrirë trupat e disa luftëtarëve suljotë. Koço Xhavela, nipi i saj, sapo kishte dhënë shpirt. Moskoja, sipas Dora D'Istria, i bëri nderimet mortore të denja për luftëtarët..., hidhet mbi trupin e tij, e puth, e mbulon me përparësën e saj dhe i thotë: “Nip i shtrenjtë, unë arrita shumë vonë për të të shpëtuar, por unë do të vrapoj të të marr hakun”. Dhe me shpejtësi, si një ortek, vihet në ndjekje...”.

Gratë çame, kur e shihnin armikun të sulmonte territoret e shtrenjta të tyre dhe t'u rrëmbente lirinë e t'i kthente në skllavëri, rrëmbejnë armët. Sulmi i tyre mbi forcat armike ishte i befasishëm dhe i vrullshëm si stuhi.

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Duke folur në podcastin “Brussels Sprouts” të organizuar nga Qendra për një Siguri të Re Amerikane (CNAS), Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se ai pret që Samiti në Vilnius të dërgojë një sinjal të fortë mbështetjeje për Ukrainën. Ai tha se të gjithë aleatët pajtohen se dera e NATO-s mbetet e hapur dhe se vetëm aleatët dhe Ukraina duhet të marrin vendime për anëtarësimin.

Z. Stoltenberg theksoi se gjëja më e rëndësishme tani është të sigurohet që Ukraina të mbizotërojë si një shtet sovran dhe i pavarur. Ai vuri në dukje gjithashtu prioritetet e tjera kyçe për Aleancën, duke përfshirë forcimin e parandalimit dhe mbrojtjes dhe një angazhim më të fortë për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes. Stoltenberg iu bashkua podcast-it së bashku me ambasadorin e SHBA-së në NATO, Julianne Smith. Ky episod shënoi dhe 5-vjetorin e podcast-it, ku u diskutua gjerësisht pushtimi i Ukrainës nga Rusia, përgjigjen e vazhdueshme ndaj luftës nga aleatët e NATO-s dhe mbështetjen për Ukrainën si dhe mësimet e nxjerra nga konflikti i deritanishëm dhe të ardhmen e Aleancës.

Plani afatgjatë i Perëndimit për të mbështetur Ukrainën

Në podcast u diskutua rreth situatës së fundit që kemi parë nga situata e luftës në Ukrainë, e cila tregon se tani ka më shumë luftime në vijat e para. Shumë të dhëna në fushën e betejës tregojnë, se do të jetë aftësia e Ukrainës për të rimarrë territorin dhe për të demonstruar se mund të përdorë pajisjet e perëndimit për të shkuar drejt faktit që do të formësojë nivelet e ardhshme të mbështetjes për Kievin.

“Luftërat janë të paparashikueshme, kështu që askush nuk mund të tregojë saktësisht se si do të evoluojë kjo luftë”, - tha Stoltenberg. “Ajo që ne dimë është se ukrainasit kanë tani aftësi, armë, municione dhe gjithashtu trajnime të ofruara nga aleatët dhe partnerët e NATO-s, jo më pak përmes Grupit të Kontaktit për Ukrainën, të udhëhequr nga SHBA-të”. Duke theksuar se ata kanë aftësitë e tyre që nevojiten për të çliruar më shumë territor, Sekretari i Përgjithshëm tha se: “Ajo që dimë gjithashtu është se ukrainasit kanë vërtetuar se janë në gjendje të shtyjnë forcat ruse, siç bënë në veri rreth Kievit, vetëm pas disa javësh, në lindje rreth Kharkiv dhe më pas në jug rreth Kherson. Tani kanë më shumë pajisje, më shumë trajnime dhe më shumë përgatitje për të çliruar edhe më shumë toka. Askush nuk mund të thotë saktësisht se si përfundon kjo luftë, por ajo që ne dimë është se ajo që ndodh rreth një tavoline negociuese në një fazë, shpresojmë se do t’i japë fund kësaj lufte”. Kjo varet tërësisht nga ajo që ndodh, në fushën e betejës, tha ai. “Pra, ne duhet të forcojmë pozicionin e Ukrainës në fushën e betejës për t’i mundësuar atyre që të marrin një rezultat të kësaj lufte që siguron që Ukraina të mbizotërojë si një komb sovran i pavarur dhe që Presidenti Putin të mos e fitojë këtë luftë”, - theksoi Stoltenberg në podcast.

B9, për përgatitje për Samitin e NATO-s në Vilnius

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, gjithashtu mori pjesë në Samitin “Bukuresht Nëntë” (B9) të Kryetarëve të Shteteve në Bratislavë, më 6 qershor 2023, për të përgatitur Samitin e Vilniusit në korrik. B9 është një platformë dhe një forum i rëndësishëm, për të adresuar edhe çështje të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme për NATO-n gjithashtu. Format i B9 bashkon Bullgarinë, Çekinë, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Lituaninë, Poloninë, Rumaninë dhe Sllovakinë dhe u krijua si pasojë e pushtimit të parë të Rusisë në Ukrainë në 2014.

“Lufta e paprovokuar e agresionit të Presidentit Putin kundër Ukrainës ka ndryshuar mjedisin tonë të sigurisë për një afat të gjatë. Rusia ka shkatërruar paqen në Evropë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Shkatërrimi i digës Kakhovka, sot vë mijëra civilë në rrezik dhe shkakton dëme të rënda mjedisore. Ky është një akt i egër që tregon edhe një herë brutalitetin e luftës së Rusisë në Ukrainë.”

Stoltenberg përvijoi prioritetet kryesore për Samitin e NATO-s në Vilnius, duke përfshirë një paketë shumëvjeçare ndihme për Ukrainën; duke forcuar parandalimin dhe mbrojtjen dhe një angazhim më të fortë për rritjen e investimeve në mbrojtje, me një minimum prej dy për qind të PBB-së. “Unë po punoj gjithashtu shumë për të siguruar që ne të mirëpresim Suedinë së shpejti si një anëtare e plotë e kësaj Aleance”, - tha ai.

Duke u takuar me kryeministrin sllovak Ludovít Ódor, pas Samitit B9, z. Stoltenberg e falënderoi atë për kontributet e Sllovakisë në NATO, përfshirë angazhimin e saj për të investuar 2% të PBB-së në mbrojtje këtë vit. Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi gjithashtu se Sllovakia mund të mbështetet në NATO, duke vënë në dukje se avionët e Aleancës patrollojnë qiejt e Sllovakisë dhe se vendi pret një grup betejë shumëkombëshe të NATO-s për të penguar çdo agresion. “Ju jeni pjesë e një familjeje prej 31 demokracish nga Evropa dhe Amerika e Veriut, ku të gjitha vendimet merren me konsensus dhe ne të gjithë

Uniteti i Aleancës dhe sfidat e sigurisë në pritje të Samitit në Vilnius



mbrojmë njëri-tjetrin. Të gjithë për një dhe një për të gjithë”, - tha ai.

Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO mbron të gjithë aleatët kundër çdo kërcënimi dhe nëse shihet një rrezik apo një kërcënim, atëherë ajo është gati për secilin aleat. “Ndërsa ne kemi mbrojtur hapësirën ajrore dhe territorin e NATO-s për dekada, ne kemi rritur praninë tonë edhe në Sllovaki brenda grupit të betejës shumëkombëshe të udhëhequr nga BE-ja e nga NATO.

“Aeroplanët e NATO-s patrollojnë qiellin mbi Sllovaki për të ndihmuar të mbrojtje të hapësirës së saj ajrore. Nëse është e nevojshme kjo gjithashtu mund të kthehet në mbështetje të aktiviteteve të mbrojtjes ajrore. NATO ka gjithashtu bateri italiane të mbrojtjes ajrore SAMP-T të vendosur në Sllovaki dhe Gjermania po i dorëzon edhe dy sisteme kundërajrore MANTIS Sllovakisë, por mesazhi më i rëndësishëm është fakti që po rritet gatishmëria e forcave dhe që kemi aftësinë t’i përforcojmë shpejt nëse nevojitet.

Nga ana tjetër nëse ka nevojë NATO do t’i shtojë aftësitë që janë tashmë në Sllovaki, grupin e betejës, sistemet e mbrojtjes ajrore, policimin ajror. Ne do t’i shtojmë më shumë aftësitë nëse nevojitet, sepse e gjithë ideja e NATO-s është se ne jemi një për të gjithë, të gjithë për një, dhe ne bëjmë atë që nevojitet për të mbrojtur të gjithë aleatët, gjithashtu hapësirën ajrore të të gjithë aleatëve”.

Ruajtja e unitetit të Aleancës dhe trajtimi i sfidave të sigurisë në Samitin e Rinisë të NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg ishte i pranishëm në Samitin e Rinisë së NATO-s, një ngjarje që bashkon liderët e rinj në Bruksel dhe Uashington DC, për të diskutuar dhe eksploruar çështje kritike për sigurinë globale, nga dezinformimi te teknologjitë më të fundit dhe nga ndryshimi i klimës në mbrojtje kombëtare.

Në një bisedë të moderuar me Dr. Kira Allman, drejtoreshë e ardhshme e Partneriteteve dhe Komunikimeve në Institutin Global të Kërkimeve William & Mary, Sekretari i Përgjithshëm foli për ruajtjen e unitetit të NATO-s gjatë viteve dhe trajtimin e sfidave të sigurisë nga lufta e Rusisë në Ukrainë deri te terrorizmi, ndryshimi i klimës dhe teknologjitë përçarëse. Ai theksoi se: “Uniteti është forca jonë më e madhe, jemi 31 kombe që janë anëtarë të NATO-s dhe së shpejti 32 me Suedinë”. Stoltenberg tha se kombet nga të dyja anët e Atlantikut, janë me histori të ndryshme, me kulturë të ndryshme dhe me parti të ndryshme politike në pushtet. “Kjo na bën të gjithëve krejt ndryshe, por në të njëjtën kohë kemi mundur të jemi bashkë si një familje e madhe dhe mendoj se qëllimi im kryesor është ta mbaj këtë familje të madhe të lumtur dhe të bashkuar”, - tha ai. “Ne jemi në gjendje të jemi bashkë pavarësisht dallimeve tona, sepse të gjithë e kuptojmë se në një botë më të rrezikshme, ne jemi më të sigurt kur jemi bashkë, Amerika e Veriut dhe Evropa”, - theksoi Stoltenberg, duke dhënë mesazhin se “të qëndruarit së bashku dhe uniteti, është forca jonë më e madhe”.

Edhe duke folur mbi sfidat gjeopolitike shefi i NATO-s tha se: “Kur shohim se fuqitë autoritare po afrohen më shumë dhe po i bashkojnë forcat më ngushtë, atëherë është edhe më e rëndësishme që të sigurojmë që të gjitha ato vende që besojnë në demokraci dhe liri të qëndrojnë së bashku në NATO, Amerika e Veriut dhe Evropa. Kjo e

bën NATO-n edhe më të rëndësishme, - tha ai. - Por edhe fakti që NATO bashkëpunon edhe përtej zonës euroatlantike me partnerët e ngushtë në Indo Paqësor, tregon se ajo beson se në një botë më të rrezikshme, ku siguria nuk është më rajonale, por vërtet globale, është edhe më e rëndësishme që NATO të punojë ngushtë me partnerët në mbarë botën”.

Samiti i Rinisë i NATO-s 2023 u organizua nga Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s në partneritet me Kolegjin e William & Mary, me temën “Liria dhe Siguria e Gjeneratës të ardhshme”. Diskutimet e panelit të Samitit të Rinisë mbuluan sfidat e sigurisë duke përfshirë kërcënimet hibride, hapësirën dhe dezinformimin. Samiti paraqiti një numër folësish nga të 31 vendet aleate të NATO-s, si dhe nga Suedia dhe Ukraina.

Stoltenberg pret me padurim finalizimin e anëtarësimit të Suedisë në Aleancë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua gjithashtu me Presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan dhe anëtarët e qeverisë së tij të re në Stamboll, pas përfundimit të zgjedhjeve të Turqisë.

Duke e quajtur Turqinë një aleate të rëndësishme dhe shumë të vlerësuar, Stoltenberg vlerësoi kontributet e trupave të Turqisë në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, duke përfshirë përforsimet pas trazirave të fundit në veri të Kosovës. Ai falënderoi gjithashtu Turqinë për kontributin në trajnimin e NATO-s për forcat irakiane, paracaktimin e trupave në grupin e betejës shumëkombëshe në Hungari dhe ofrimin e mbështetjes së fortë për Ukrainën, përfshirë udhëheqjen e nismës së grurit të Detit të Zi.

Sekretari i Përgjithshëm e uroi Presidentin Erdogan për rizgjedhjen e tij dhe për pjesëmarrjen e lartë të popullit turk në votime. Ata diskutuan një sërë çështjesh në agjendën e Samitit të NATO-s të korrikut në Vilnius, duke përfshirë mbështetjen për Ukrainën, punën për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen dhe luftën kundër terrorizmit. Diskutimet përfshinë gjithashtu ofertën e Suedisë për anëtarësim në NATO. Stoltenberg vuri në dukje se Stokholmi ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, konkretë për të përmbyshur shqetësimet e Turqisë, duke përfshirë ndryshimin e kushtetutës suedeze, përfundimin e embargos së armëve dhe rritjen e bashkëpunimit kundër terrorizmit, përfshirë kundër PKK-së. Ai më tej vuri në dukje se legjislacioni i ri i rëndësishëm kundër terrorizmit ka hyrë në fuqi ditët e fundit dhe se Suedia ka përmbyshur detyrimet e saj. Ai tha se ishte e vështirë të shiheshin demonstrata kundër Turqisë dhe kundër NATO-s në Suedi, por organizatorët nuk duhet të lejohen të kenë sukses në përpjekjet e tyre për të bllokuar bashkëpunimin kundër terrorizmit dhe për të ndaluar Suedinë të bashkohet me Aleancën.

Sekretari i Përgjithshëm dhe Presidenti Erdogan ranë dakord që Mekanizmi i Përhershëm i Përbashkët midis Turqisë, Finlandës dhe Suedisë duhet të takohet përsëri në javën që fillon, më 12 qershor. Stoltenberg tha se mezi priste të finalizonte pranimin e Suedisë së më shpejt të jetë e mundur.



NGA SALI ONUZI

Në bregun lindor të Liqenit të Shkodrës u zhvillua ceremonia e dhënies së statusit “Dëshmor i Atdheut”, 277 të rënë në Kryengritjen e Malësisë së Madhe kundër forcave pushtuese osmane.

Në këtë ceremoni mori pjesë Kryetari i Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e Atdheut, z. Gjergji Velo, dhe autoritetet vendore, kryetari i këshillit të qarkut të Shkodrës z. Ilmi Lakti, prefektja e Qarkut znj. Majlinda Angoni dhe i dërguari i Ministrisë së Mbrojtjes z. Behar Salillari. Në Ceremoni morën pjesë familjarë të Dëshmorëve, qytetarë nga Malësia e Madhe dhe Shkodra, përfaqësues të Organizatave për Dëshmorët e Atdheut nga disa rrethe të vendit, si znj. Marie Bardhok Biba nga Mirdita, znj. Dhurata Tyli nga Shkodra, z. Sefer Duka nga Mati etj.

Ceremoninë e hapi kryetari i Bashkisë së Malësisë së Madhe z. Tonin Marinaj, që vlerësoi lart veprën e burrave dhe grave të Malësisë në Kryengritjen e vitit 1911, dhe në veçanti të atyre që dhanë jetën në luftimet e zhvilluara. Mes të tjerash ai shprehu kënaqësinë e tij edhe për faktin se statusin e lartë të Dëshmorit të Atdheut e merrte edhe gjyshi i tij.

Gjithashtu përshëndetën, z. Gjergji Velo, i cili vlerësoi lart trimërinë dhe sakrificat e trimave të Malësisë së Madhe, që i quajti “trima me fletë”, falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Komisionin Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut, që miratoi statuset përkatës. Ai falënderoi në veçanti z. Shaqir Vukaj, anëtar i Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut dhe nënkryetar i Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e Atdheut dhe gjithë institucionet dhe individët që u përfshinë në këtë veprimtari hulumtuese, kërkuese, historike, atdhetare dhe juridike.

Në fjalën e tij z. Shaqir Vukaj tregoi se ishte bërë një punë kolosale për të kërkuar e paraqitur para autoriteteve vendore e Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut fakte e argumente për qëndresën dhe rënien heroike të 277 djemve dhe burrave të Malësisë, që ranë duke luftuar në kryengritjen anti-osmane të vitit 1911, që ngritën lart në majën e Bratilës, më 24 mars 1911, flamurin kuq e zi me shqiponjën dykrenore.

Në këtë veprimtari e morën fjalën dhe historiani Ndue Bacaj, studiuesi Mark Vuçaj, Xhemal Brahja, kryetar i Shoqatës kulturore atdhetare “Sofra e Malësisë së Madhe”, me qëndër në Tiranë, krijues i mirënjohur Kadri Ujka etj. Në takim foli dhe përshëndeti edhe Vasel Berisha nga Komuna e Tuzit të Malit të Zi.

Më pas, me një solemnitë të veçantë, nën jehonën e tingujve të Lahutës, autoritetet vendore ndanë për familjarët e Dëshmorëve të shpallur dokumentet përkatëse, Certifikatën e firmosur e vulosur nga Ministria e Mbrojtjes dhe flamurin “Familje e Dëshmorit të Atdheut”, për çdo rast.



“Sot trevës sonë iu bë një nder i madh, sepse gjaku i 277 të rënë në kryengritjen e Malësisë së Madhe, 1911, nuk u harrua, nuk u tret, nuk u tjetërsua, por me shpalljen “Dëshmorë të Atdheut” të këtyre djemve dhe burrave malësorë, e gjithë Shqipëria nderon dhe lartëson sakrificën e bijve tanë!”, - do të shprehnin mirënjohjen e tyre përfaqësuesit e bashkisë dhe opinionin shoqëror për këta djem dhe vajza që dhanë jetën e tyre për të shenjtën liri të Atdheut.

Kryengritja e vitit 1911, e Malësisë së Madhe, u zhvillua nga 24 marsi deri më 2 gusht të atij viti. Ajo filloi me veprimet e armatosura të malësorëve të Hotit të udhëhequr nga Ded Gjo Luli, nga Gjek Marash Gjeloshi etj., kundër fortifikatës së ushtrisë osmane në Rrapsh, në Grudë, në Kelmend e në Kastrat. Kudo në këtë fazë çetat e kryengritësve ishin në sulm.

Shqipëria dhe Malësia e Madhe nderojnë 277 Dëshmorët e Atdheut të Kryengritjes së vitit 1911



Posta e Rrapshës me 30 ushtarë turq u sulmua dhe u mor nga 18 malësorë që kishin vetëm 7 pushkë. Kështu edhe posta e Traboinit.

Në gjithë Malësinë e Madhe ishin ngritur rreth 3 000 kryengritës. Më 28 mars ata çliruan qytezën e Tuzit. Më 30 mars sulmuan Koplikun, por për mungesë armësh e municionesh u tërhoqën. “Do të kishim marrë Shkodrën”, - pat shkruar Luigj Gurakuqi. Por ndërkohë kishin arritur të çlironin gjithë Malësinë e Madhe (HAUSH V.2,f.340).

Më 30 mars, në Cetinë udhëheqësit e kryengritjes miratuan një memorandum për Fuqitë e Mëdha. Kryengritësit dolën me kërkesa kombëtare që në thelbin e tyre ishin autonomiste.

Më 6 prill 1911, u zhvilluan përleshje të përgjakshme kundër forcave turke prej Tuzi e në Kastrat. Kulmi i tyre arriti në majën e Deçiqit, ku 350 ushtarë turq u sulmuan nga 80 malësorë, gjysma e të cilëve ishte e paarmatosur, por ia dolën të asgjësonin 30 ushtarë turq.

Atë ditë mbërritën në fushën e luftimit 7 malësorë shqiptarë, ‘çeta e Flamurit’ (sipas Prenk Ulit). Çetës i printe Dek Preçi me Flamur në dorë. Mbas tij shkonin dy vëllezër binjakë, Tom Uçi dhe Kol Uçi, mandej vinin më radhë Gjeto Gjeka, Marash Luca, Kol Doda, Gjeto Toma e Prel Gjeka. Të gjithë të vendosur për të ngritur Flamurin e Shqipërisë, Flamurin e Skënderbeut në Deçiq. Jo shumë larg llogoreve turke mjegulla filloi të shpërndahej dhe trimat u diktuan nga armiku, që i qëllonte pa pushim. Po binin njëri pas tjetrit. Sulmuesit malësorë të frymëzuar nga akti i flamurbajtësve kërcyen në llogoret turke dhe u përleshën me to fyt më fyt. Turqit u tërhoqën dhe disa u dorëzuan. Prel Gjeka, që kish mbetë i fundit nga çeta e Flamurit, kërcëu si shqipe mali dhe e nguli Flamurin e Shqipërisë brenda në llogoren turke. Po një breshëri plumbash e shtrinë për tokë nën hijen e tij. Flamurin e ngritur mbi kalanë e Deçiqit e kish qëndisur shkoderania Bernardina Marubi. Ky heroizëm është fiksuar si në tregimet e bashkëlufëtarëve dhe në këngët e popullit dhe në Historinë e Shqipërisë. Vëllimi II i Akademisë së Shkencave të RPSSH, f.452 dhe Halil Katana, “Flamuri ynë”, Tiranë, 2005, f.17-19.

Gjatë tri javëve rresht xhonturqit nuk mundën jo vetëm t'i nënshtronin malësorët, por as të lidheshin me garnizonin e rrethuar të Tuzit dhe as të përforcoheshin në Deçiq.

Më 17 prill zbarkoi në Shëngjin gjenerali turk Shefqet Turgut Pasha me 8 batalione, me 5000 ushtarë, dy bateri malore, një divizion mitraljer, 800 kuaj dhe 10 mijë pushkë e materiale të shumta luftarake. Më 18 prill ato hynë në Shkodër. Por kryengritësit në radhët e të cilëve luftonte edhe Luigj Gurakuqi, Hilë Mosi etj., nuk

i ndalën sulmet. Më 1 maj ata shpallën edhe një proklamata të shkruar në disa gjuhë europiane, ku parashtruan edhe njëherë programin e tyre autonomist.

Në ditët e para të prillit e në vazhdim kryengritësit u kthyen në luftime mbrojtëse. Gjatë prillit dhe gjysmës së parë të majit forcat turke ishin shtuar shumë, me 48 batalione këmbësorie me një efektiv prej 30 mijë vetash. Me 4 divizione turqit rrethuan gjithë Malësinë e Madhe dhe i detyruan kryengritësit të zhvillonin luftime mbrojtëse në rrethim. Ushtria turke organizoi e zhvilloi tri goditje bashkëqendrore me objektiv asgjësimin e kryengritësve, djegien e shtëpive të tyre dhe shkatërrimin e kishave. Po edhe në këtë fazë të dytë kryengritësit, mbështetur në pozita kyçe të terrenit, bënë një qëndresë tepër këmbëngulëse e të përgjakshme. Luftimet hynë në fazën e tyre vendimtare.

Por në fillim të qershorit kryengritësit u detyruan të tërhiqeshin për të ngushtuar rajonin e mbrojtjes së tyre. Më 23 qershor u mbledh në pllajën e Greçës Kuvendi i Përgjithshëm i krerëve shqiptarë, i cili miratoi dokumentin më të rëndësishëm të kryengritjes “Momerandum i Greçës”, i hartuar nga Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi. Kryengritja e shqiptarëve të Veriut u pajis kështu me një program kombëtar për autonominë e Shqipërisë. Ndonëse me vonesë edhe në Jug të Shqipërisë çeta të kryengritëse u hodhën në sulm kundër disa prej garnizoneve osmane.



Por kryengritja për disa shkaqe tanimë të njohura, nuk u kthye dot në një kryengritje të përgjithshme, prandaj prej mesit të qershorit dhe fundi i korrikut luftimet erdhën duke rënë. Në ditët e para të gushtit të dy palët arritën një marrëveshje armëpushimi.

Vetë Turgut Pasha detyrohej të pranonte se “çdo ditë janë bërë përpjekje të ashpra e të vazhdueshme dhe kryengritësit i kanë dalë zot çdo shkëmbi, çdo shtëpie dhe e kanë lënë vendin (të shkelet) vetëm, duke dhënë jetën” (Histori e Shqipërisë, v. II, botim 1984, fq. 454.)

Në këtë luftë të pabarabartë, shqiptarët e Malësisë së Madhe lanë në fushën e betejës 277 të rënë (të identifikuar deri më sot), që i bie 6.9. % të efektivit në një periudhë prej 98 ditë luftimesh (nga 26 prill deri me 2 gusht 1911). Shënojmë se në Luftën ANÇ i bie të jenë vrarë 15,1 % e efektivit dhe koeficienti i rënies, në LANÇ është 8,7 partizanë (ushtarë e vullnetarë) në ditë, në luftën e Malësisë së Madhe i takon 6.8 të rënë në ditë mesatarisht. (Në të dy rastet nuk janë llogaritur të vdekurit nga uria ose të internuarit etj.) Koeficienti i të rënëve në Kryengritjen e Malësisë së Madhe është, sipas mendimit tim, edhe një tregues i aftësive luftarake ,i shfrytëzimit mjeshtëror të terrenit alpin dhe i të luftuarit në mbrojtje në pjesën më të madhe të kohës.

Kërkimet për veprimtarinë luftarake të tyre, dokumentet e paraqitura dhe miratimi i tyre janë bërë me seriozitetin që kërkon ligji i statusit të Dëshmorit të Atdheut. Tani pas 112 vjetësh ka hyrë në jetë brezi i katërt i tyre, nipat dhe mbesat, stërnipat e stërmbesat e tyre. Por gëzimi i madh i tyre për vlerësimin e veprës së gjyshërve të tyre ishte i dukshëm bashkë me krenarinë e një “familje Dëshmori të Atdheut”!

Lavdi veprës së tyre të pavdekshme!



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Adoleshentët janë shndërruar në “mbretër” të krimit. Bëhet fjalë për mijëra minorenë, që ende pa mbushur të tetëmbëdhjetat, e gjejnë emrin e tyre nëpër skedat e policisë, si hajdutë, por edhe vrasës gjakftohtë. Shifrat më të fundit të policisë për grupmoshat që kryejnë më shumë vrasje janë tronditëse. Mbi 56% e vrasjeve kryhen nga të rinj, që nuk janë më shumë se 25 vjeç dhe shumica e tyre nga adoleshentë 12 deri në 18-vjeçar, këto janë deklarata të policisë dhe kronikave të lajmeve të çdo ditë. Tashmë ky fakt po trondit familjet shqiptare.

Çfarë po ndodh me adoleshentët shqiptarë?

Kohët e fundit janë shtuar shumë rastet e vrasjeve mes minorenësh, interesant do të ishte fakti nëse do të zbulonim arsyet se përse këta persona të çfarëdoshëm papritur shndërrohen në kriminelë dhe çfarë ka ndikuar tek ata që i ka bërë të aftë për të marrë përsipër kryerjen e një krimi apo mos vallë ata lindin të tillë... Nëse do të ishin njerëz normalë dhe papritur shndërrohen në kriminelë sepse kryejnë një krim të parashikuar si vepër penale në Kodin Penal, atëherë do të thotë se diçka i ka nxitur që të kryejnë një vepër të tillë, diçka nga mjedisi që i rrethon, i ka bërë që të marrin guximin e të vrasin dikë tjetër.

Po shkojmë drejt një shoqërie të mbizotëruar nga krimi

Nuk ka dyshim që transformimet e shpejta, kaotike, të paqëndrueshme politike, ekonomike e sociale në Shqipëri, kalimi i përsheptuar i shoqërisë nga një epokë e shoqërisë së turmës në atë të njeriut të lirë, patjetër që do të sillte paqartësi e keqkuptime konceptuale për lirinë, mënyrën e ndërtimit të raporteve të njeriut me të. Duke e parë nga kjo anë, është e natyrshme që tek shumë njerëz të krijohet bindja, se shtimi i përmasave të krimit në shoqëri dhe konsiderimi i tij si dukuri sociale anormale, duhet vlerësuar së pari nga ana e faktorëve socialë dhe ndikimeve të tjera të jashtme mbi thelbin dhe natyrën e njeriut postmodern.

Pse arrin adoleshenti të vrasë?

Ana e errët e adoleshentëve që vrasin është kthyer në qendër të lajmeve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ngjallur zhurmë dhe shpërqendrim. Kemi raste të nënave që vrasin veten, duke vendosur të marrin fëmijët e tyre me vete gra që, pas hamendësimit të planeve djallëzore, vrasin burrat e tyre, burra (shumica e tyre) që marrin jetën e grave të tyre dhe që ndonjëherë kryejnë vetëvrasje.

Kur një adoleshent vret, modeli është gjithmonë i njëjtë. Në mentalitetin aktual, adoleshentët që kryejnë vrasje janë të zhytur në ‘çmenduri’, dhunë në familje dhe pakujdesi prindërore. Në një epokë si kjo e sotmja, pa shenjtorë apo heronj, marrëdhëniet me figurat e



referencës janë të paqëndrueshme, dhe të tejmbushura me tensione. Prindërit gjithnjë e më shumë i ngarkojnë fëmijët e tyre me pritshmëri, duan që ata të jetojnë në një komunitet që imponon ritme të acaruara.

Është e vështirë të ndihesh si një dështim në një shoqëri “sociale” të fituesve.

Vajzat e reja nuk vriten nga duart e anëtarëve të familjes, por privohen nga ekzistenca e tyre si të fejuara apo të dashura, miqtë apo të njohur, të cilët, në shumicën e rasteve, nuk i nënshtrohen logjikës së refuzimit. Sikur përdorimi i dhunës barbare të ishte zgjidhja e vetme për të hequr qafe kërcënimin e humbjes.

Sikur të mos mund të merrej parasysh mundësia e përballimit të disfatave. Sikur vendimi i papritur për t’i dhënë fund një marrëdhënieje ose refuzimi seksual nuk la rrugë tjetër përveç asaj të agresionit dhe dhunës. Problemi është sigurisht kulturor tek adoleshentët meshkuj në një moment kur diçka prishet...

Dhuna demonstroi paaftësinë për të menaxhuar emocionet dhe traumat e pjekura në fazat e strukturimit të personalitetit mund të kenë pasoja dramatike, që lënë gjurmë përjetë.

Adoleshentë kriminelë.

Arsyet pse vrasin

Gjithnjë e më shpesh të rinjtë po vrasin. Çfarë futet në mendjen e këtyre djemve?

Krimi ka qenë gjithmonë pasqyra e shoqërisë në të cilën jetojmë dhe nëse shoqëria e sotme na duket e prishur dhe pa horizonte, ajo thjeshtë është shtrirë në kohë dhe ka transformuar llojin por përfundimin. Standardi është humbur dhe pastaj gjithçka bëhet e njëjtë.

Në rastin e adoleshentëve a mund të flasim vetëm për dhunim apo mund të ketë edhe paramendim, duke pasur parasysh moshën e re? As njëra, as tjetra. Në shumë raste besoj se asgjësimi

i tjetrit tashmë është zbatuar prej vitesh, ka kohë. Zemërimi ndaj tjetrit, duke shkatërruar dhe asgjësuar personin që e do, ose mikun, shokun, rivalin, i përgjigjet një logjike shkatërruese që tashmë është krijuar ka kohë.

Vërejmë simptomat, jo shkaqet, “paramendimi” i një krimi tek një adoleshent ka elemente të përbashkëta me atë të planifikuar nga një i rritur?

Konceptualisht po. Praktikisht jo. Konceptualisht po, sepse në të dyja rastet krimi përmbledh një jetë. Kjo ndodh shpesh nëse bëjmë një përjashtim për krimet fajtoresh, sepse është precipitimi i një serie të tërë elementësh. Në praktikë jo, sepse në fazën e adoleshencës, për të rinjtë, krimi merr një ton edhe më dramatik.

Në më pak se tre javë, në konflikte ku janë përfshirë të rinj të cilët kanë përdorur armë apo thikë, janë plagosur 7 persona e 1 ka humbur jetën.

Agresiviteti i të rinjve është i lidhur ngushtësisht me frymën që dominon në shoqërinë shqiptare.

Shoqëria shqiptare sot po përjeton një situatë shumë të rëndë, përjeton një situatë ku njerëzit dhe kriminelët bëhen të famshëm për një kohë të shkurtër. Madje shpesh është krijuar bindja se, adoleshentët jo të mirëformuar mund të bëhen të njohur po të angazhohen në krime të rrezikshme.

Familja po ashtu lipset të bëjë më shumë. Nënata kanë rol kyç në rritjen e edukimin e fëmijëve, andaj duhen ndërmarrë politika mbështetëse ndaj tyre.

Agresiviteti nga përdorimi i rrjeteve sociale

Ndikojnë shumë, kanë krijuar një frymë vulgariteti dhe jeta nuk ka më atë elegancën, bukurinë, fisnikërinë dhe romantizmin. Pra si i fyeri dhe fyesi duken në gjendje normale.

Çfarë duhet bërë?

Arsimimi i mirë është kusht themelor për të shmangur rrezikun e të rinjve. Mungesa e shkollimit dhe analfabetizmi i vërtetë apo funksional, është arsyeja madhore që po ndikon fare hapur që në shoqëri, sidomos në jetën e periferive urbane e rurale. Në lagjet e vesit dhe krimit shfaqen shpesh herë njerëz të pakultivuar dhe të paqytetëruar, të cilët nganjëherë, kur përballesh me ta dhe sjelljen e tyre antisociale, të ngjajnë më shumë si “egërsira të hutuara”, pikërisht ngaqë kanë mungesa të thella të njohurive humane dhe parimeve sociale të ndërtimit dhe komportimit me jetën qytetare. Nga ana tjetër, që të zvogëlojmë krimin në shoqërinë tonë, duhet të institucionalizojmë përpjekjet e familjes, shkollës, shoqërisë, medias, shtetit, politikës për të rindërtuar një strategji të përgatitjes së njerëzve me aftësi sociale e ndërgjegje të urbanizuar.

Është emergjente situata e vrasjeve, dhunës psikologjike dhe fizike, bulizimi tek fëmijët tanë, nuk ka kohë për fjalë, por për reagim që e ardhmja të mos na sjellë tragjedi në vatrat tona.

Nuk ka pse fshihemi përballë situatës së vërtetë të krimit në shoqërinë tonë, i cili është në dimensione alarmante. Prandaj, duke parë me realizëm kurbën e krimit në shoqëri, tendencën në rritje dhe zgjerimin e përmasave të dëmeve sociale që vijnë prej tij, është e natyrshme të pranojmë se jemi në një situatë, që nëse nuk ndryshon, të detyron të bësh parashikime të zymta për gjendjen sociale të shoqërisë dhe pranisë së zgjeruar të njeriut kriminal.



Lufta kundër dhunës ndaj grave: Këshilli miraton vendimin për pranimin e BE-së në Konventën e Stambollit

Këshilli European miratoi aderimin e BE-së në Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

“Dhuna ndaj grave është e papranueshme dhe duhet të marrë fund. Këto akte nuk kanë vend në shoqëritë tona. Konventa e Stambollit është një pikë referimi dhe një katalizator për veprim. Vendimi i sotëm për anëtarësimin në BE tregon përkushtimin tonë për të rritur veprimet kundër dhunës me bazë gjinore dhe në mbështetje të viktimave të saj”, - Paulina Brandberg, ministre Suedeze për Barazinë Gjinore dhe zëvendësministre për Punësimin.

Konventa ofron një kuadër ligjor të detyrueshëm

Konventa krijon një kuadër ligjor për të mbrojtur gratë nga dhuna. Ai mbulon një gamë të gjerë masash, nga mbledhja e të dhënave dhe ndërgjegjësimi deri te masat ligjore për kriminalizimin e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave. Ai përfshin masa për mbrojtjen e viktimave dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe trajton dimensionin e dhunës me bazë gjinore në çështjet e azilit dhe migracionit.

Barazia midis burrave dhe grave Aderimi i BE-së në Konventë është një nxitje për përpjekjet e BE-së për të realizuar barazinë midis grave dhe burrave. Dhuna ndaj grave është jo vetëm një vepër penale, por edhe



një pasojë ekstreme e diskriminimit, e rrënjësuar në pabarazitë gjinore. Në të njëjtën kohë, dhuna ndaj grave kontribuon në ruajtjen dhe forcimin e këtyre pabarazive.

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është instrumenti i parë ndërkombëtar që

synon eliminimin e dhunës ndaj grave, përfshirë vajzat nën moshën 18 vjeç. Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një nga shkeljet më sistematike dhe më të zakonshme të të drejtave të njeriut në nivel global. Një në tre gra ka përjetuar dhunë fizike ose seksuale, kryesisht të ushtruar nga partnerët intimë.

Perspektiva gjinore është thelbësore për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Komisioni Evropian ka njoftuar masa të reja për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo vjen si përgjigje ndaj një raporti të vitit 2021, që vlerësonte efektivitetin e Direktivës kundër Trafikimit të BE-së të vitit 2001, e cila konstatoi se përgjigja e shteteve anëtare ishte e pamjaftueshme. Opinioni i KESE-së kërkon një fokus gjinor, mbështetje më të madhe për viktimat, më shumë llogaridhënie për kompanitë dhe përmirësim të mekanizmave monitorues.

Direktiva Kundër Trafikimit është akti themelor legjislativ i BE-së që trajton trafikimin e qenieve njerëzore. Ai vendos rregullat minimale në lidhje me veprat penale dhe sanksionet, mbrojtjen e viktimave dhe masat parandaluese, por vendimin përfundimtar për kriminalizimin e përdorimit të njohurive të shërbimeve të shfrytëzuara nga personat e trafikuar ia lë shteteve anëtare, duke çuar në një peizazh të ndryshëm ligjor në të gjithë BE-në. Raporti i vitit 2021 tregon se si këto mospërputhje kanë penguar përpjekjet për të ulur kërkesën në mënyrë efektive dhe përtej kufijve.

Komiteti thekson se faktorët kryesorë që ndikojnë në gjasat për t'u trafikuar kanë një dimension të qartë gjinor. Ka të ngjarë që pabarazitë në aksesin në arsim dhe punë, kujdes shëndetësor dhe social, si dhe pabarazi të tjera sociale që ekzistojnë midis burrave dhe grave, i bëjnë këto të fundit më të cenueshme ndaj trafikimit.

Raportuesi i opinionit të KESE-së, Jose Antonio Moreno Diaz shpjegoi se 51% e viktimave trafikohen për shfrytëzim seksual, 88% e të cilëve janë femra, nga të cilat 21% janë vajza. Këto të dhëna janë të frikshme.



Shumica dërrmuese e viktimave janë gra dhe vajza. Ne kemi nevojë për një perspektivë gjinore në përmbajtjen dhe zbatimin e direktivës, kërkoj z. Moreno Diaz.

Në opinionin e tij, KESE rekomandon që:

Direktiva duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje viktimave të trafikimit. Në veçanti, opinioni thekson detyrimin e Shteteve Anëtare për t'u kujdesur dhe mbrojtur për viktimat dhe për të siguruar përfshirjen e tyre sociale. Në mënyrë të ngjashme, vëmendje duhet t'i kushtohet situatave të cenueshme që mund të lehtësojnë rekrutimin dhe shfrytëzimin nga rrjetet kriminale dhe të tjerët. Kategoritë e cenueshme përfshijnë refugjatët, azilkërkuesit dhe personat që nuk kanë dokumente ose kanë një status të pasigurt qëndrimi. Direktiva duhet të jetë në përputhje me Direktivën 2004/81/KE për lejen e qëndrimit të lëshuar për shtetasit e vendeve të treta që janë viktimat të trafikimit ose që kanë qenë subjekt i veprimeve që lehtësojnë migracionin e parregullt dhe bashkëpunojnë me autoritetet kompetente. Kompanitë që përfitojnë nga shfrytëzimi duhet të mbajnë përgjegjësi. Kjo mund të arrihet duke lidhur përdorimin e vetëdijshëm të shërbimeve të shfrytëzimit me Direktivën për Kujdesin e duhur të Qëndrueshmërisë së Korporatave. Mjetet e mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave duhet të përmirësohen për të identifikuar veprat penale në mënyrë më efektive. Përdorimi i teknologjive të reja ka inkurajuar veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, duke lejuar dhe lehtësuar aksesin dhe shfrytëzimin më të madh të viktimave, dhe duke krijuar më shumë vështirësi kur bëhet fjalë për monitorimin e fitimeve që rrjedhin nga këto vepra. Propozimi po merr vull. Në Këshillin e BE-së, një qasje e përgjithshme e propozimit pritet të arrihet këtë qershor.



‘Pakti për Aftësitë’ ka ndihmuar tashmë 2 milionë njerëz që përfitojnë nga aktivitetet e reja dhe rikualifikuese

Rezultatet e anketës vjetore të ‘Paktit për Aftësitë 2022’ janë paraqitur. Pakti i BE-së për Aftësitë ka ndihmuar ndjeshëm kompanitë dhe punëtorët në të gjithë Evropën në avancimin e trajnimit të aftësive. Sipas sondazhit, 2 milionë njerëz kanë përfutur nga aktivitetet e ngritjes dhe rikualifikimit sipas Paktit. 15,500 programe trajnimi ose u përditësuan ose u zhvilluan, dhe anëtarët e Paktit kanë investuar 160 milionë euro në iniciativat e aftësive.

Ky është një kontribut i rëndësishëm për Vitin Evropian të Aftësive

Duke bashkuar industrinë, partnerët socialë, ofruesit profesional dhe arsimor, autoritetet publike, shërbimet e punësimit dhe të tjerë në sektorë të ndryshëm, Pakti për Aftësitë promovon një qasje kolektive për të trajtuar sfidat dhe mungesat në zhvillimin e aftësive. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një botë pune që ndryshon me shpejtësi dhe për tranzicionin e gjelbër dhe atë dixhital. Mbi 80% e anëtarëve të Paktit të anketuar vlerësojnë mbështetjen e dhënë nga Pakti për të siguruar oferta konkrete trajnimi për punëtorët në të gjithë Evropën.

Partneritetet e aftësive sipas Paktit janë dëshmuar efektive në adresimin e nevojave për aftësi sektoriale dhe kanë pasur një ndikim pozitiv në rritjen e aftësive të punëtorëve. Deri më sot, 1,500 organizata i janë bashkuar ‘Paktit për Aftësitë’, me 18 partneritete në shkallë të gjerë të aftësive të krijuara në sektorë strategjikë si energjia e rinovueshme, sektori i kujdesit dhe mikroelektronika. Kjo do të thotë se të paktën një partneritet i shkathësive në shkallë të gjerë është krijuar për çdo ekosistem industrial të Strategjisë Industriale të BE-së. Së bashku, të gjitha partneritetet janë zotuar të ofrojnë trajnime për mbi 10 milionë njerëz në vitet e ardhshme.

Raporti i sondazhit tregon gjithashtu shembuj konkretë të veprimeve të suksesshme të aftësive nga anëtarët e Paktit në të gjithë Evropën. Si p.sh. ‘Femxa Formación’ në Spanjë lehtësoi integrimin e mbi 60 grave me prejardhje migrante në tregun e punës në Letoni dhe Spanjë nëpërmjet programeve të trajnimit.

Organizata ‘Wheel’ në Irlandë nisi një Akademi Liderशिpi për të mbështetur zhvillimin e aftësive në sektorin e ekonomisë sociale në Irlandë. Platforma ofron materiale trajnimi të synuara dhe burime përkatëse.

Bashkia e Lisbonës prezantoi një projekt “Pasaporta e Aftësive Dixhitale” për mikrokredencialet e aftësive dixhitale.

Qendra ‘Emphasys’ në Qipro, në partneritet me një OJQ, e vë në dispozicion qëndrën e tyre të të mësuarit gjatë orëve jashtë pune për të ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive për grupet vulnerabël, duke përfshirë të rinjtë dhe njerëzit me prejardhje migrante, të moshuarit dhe punëkërkuesit.

Federata Evropiane e Shoqatave të Guidave Turistike projekttoi klasa master për të përmirësuar aftësitë e trajnerëve për udhërrëfyes turistik, duke u fokusuar në përfshirjen dhe aftësitë dixhitale.

Gjetje të tjera kryesore

Sondazhi zbulon ndikimin pozitiv dhe konkret të partneriteteve të aftësive në shkallë të gjerë në fuqizimin e punëtorëve me aftësitë e nevojshme për sukses. Për sektorët e tyre, anëtarët e Paktit kanë raportuar një monitorim të zgjeruar të aftësive të nevojshme, një disponueshmëri më të madhe të mundësive të trajnimit me cilësi të lartë dhe zbatimin e aktiviteteve më gjithëpërfshirëse për të rritur aftësitë.

Së bashku, 21,500 palë të interesuara kanë bashkuar forcat përmes partneriteteve ose rrjeteve të aftësive (p.sh. grupime industriale) për të nxitur iniciativat me ndikim të zhvillimit të aftësive dhe kanë arritur 19 milionë njerëz në Evropë përmes aktiviteteve të promovimit dhe shpërndarjes.

Inteligjenca Artificiale e shpjegueshme ka nevojë për inteligjencë njerëzore

Modelet moderne të Inteligjencës Artificiale (AI) shpesh punojnë si motorë të errët vendimmarrës (kutitë e zeza); arritjen e përfundimeve pa shumë transparencë apo shpjegime se si arrihet një rezultat i caktuar. Në një epokë ku AI-ja është bërë një pjesë integrale e jetës sonë, ku rekrutuesit, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe fusha të tjera, mbështeten në këtë mjet për të marrë vendime që ndikojnë tek individët, të kuptuarit se si funksionon AI-ja është thelbësore.

A mund të jetë Inteligjenca Artificiale e Shpjegueshme, ose XAI, një rrugë përpara, një zgjidhje e mundshme? Por, çfarë është XAI, si funksionon në praktikë? Cilat janë përfitimet e tij, por edhe rreziqet, marrëdhënia e tij me mbrojtjen e të dhënave? Çfarë ndikimi mund të ketë XAI në vitet në vijim?

Këto janë disa nga pyetjet që folësit dhe ekspertët e shquar trajtuan gjatë ngjarjes hibride të Rrjetit të Inxhinierisë së Privatësisë së Internetit të EDPS (IPEN).

IPEN, i krijuar pothuajse 10 vjet më parë nga EDPS, mbledh së bashku ekspertë të mbrojtjes së të dhënave dhe teknologjisë, si dhe aktorë të tjerë përkatës, për të diskutuar sfidat përkatëse të përfshirjes së kërkesave për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë në zhvillimin e teknologjive. Forumi gjeneron pikëpamje nxitëse për mendime, shkëmbime magjepsëse, të cilat, si për shumë të tjerë, informojnë dhe ushqejnë reflektimet për marrëdhënien e ngushtë midis privatësisë dhe teknologjisë. Kjo ngjarje IPEN në XAI nuk ishte përjashtim.

Pse XAI?

XAI fokusohet në zhvillimin e sistemeve të AI-së, që jo vetëm që mund të ofrojnë parashikime dhe vendime të sakta, si sistemet e tjera të AI-së, por gjithashtu mund të ofrojnë shpjegime se si arrihet një vendim ose përfundim i caktuar. Me fjalë të tjera, XAI duhet të jetë në gjendje të shpjegojë se çfarë ka bërë, çfarë do të ndodhë më pas dhe çfarë informacioni është përdorur për të marrë një vendim. Me këtë informacion, individët që përdorin XAI do të jenë në gjendje të kuptojnë arsyetimin pas një vendimi të automatizuar dhe të ndërmarrin kursin e duhur dhe të informuar të veprimit. Me XAI, ndryshimet dinamike: përdoruesit nuk do të mbështeteshin thjeshtë në sistemet e AI-së për të marrë vendime për ta, por do të luanin një rol integral në marrjen ose verifikimin e një vendimi. Për këtë qëllim, XAI - i shoqëruar me njohjen njerëzore - mund të luajë një rol të rëndësishëm në nxitjen e besimit në sistemet e AI-së, si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së sistemeve të AI-së.

XAI, llogaridhënia, transparenca dhe mbrojtja e të dhënave, si përfundojnë të gjitha?

Si funksionon e gjithë kjo në praktikë? Si mund të arrihet vërtet transparenca dhe llogaridhënia? Nuk do të jetë e mjaftueshme nëse shpjegimet e dhëna nga një sistem AI janë shumë teknike - të kuptueshme vetëm nga një pjesë e vogël e ekspertëve.

Transparenca dhe llogaridhënia efektive, dhe për rrjedhojë besimi në sistemet e AI-së, mund të arrihet realisht vetëm nëse informacioni në lidhje me sjelljen themelore të një sistemi mund të shpjegohet me thjeshtësi të vërtetë dhe të sinqertë, dhe në një mënyrë të qartë dhe koncize, në mënyrë që kjo njohuri të mund të transmetohet. nga ofruesi të përdoruesit e sistemeve të AI-së. Marrja e informacionit të qartë në lidhje me sjelljen e AI-së, ka gjithashtu një ndikim në aftësinë e përdoruesve të saj, siç janë kontrollorët dhe përpunuesit e të dhënave, për të vlerësuar rreziqet që ky mjet mund të



sjellë për të drejtat e individëve për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë, për t'i mbrojtur ata dhe të dhënat personale.

XAI dhe rreziqet e tij

A është e lehtë të shpjegohet AI-ja në një mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe koncize? Epo, jo me të vërtetë. Të bësh AI-në të kuptueshme dhe kuptimplote për të gjithë është sfiduese për t'u arritur pa kompromentuar saktësinë parashikuese të AI-së. Me siguri, një nga rreziqet është se shpjegimet mund të bëhen subjektive, bindëse dhe jo informative, ose të hapura për interpretim, të varura nga konteksti, të cilat u ndanë nga disa pjesëmarrës në ngjarjen IPEN. Filtrat kulturorë gjithashtu mund të luajnë një rol. Ndoshta nuk ka

një mënyrë të vetme për të shpjeguar se çfarë bën një sistem AI, por sigurisht që ka shumë mënyra të gabuara për ta bërë këtë.

Rreziqet ndaj privatësisë dhe të dhënave personale të individëve duhet të konsiderohen gjithashtu seriozisht. Me XAI, rezultatet e prodhuara nga sistemet e AI-së mund të zbulojnë informacione personale për individët.

Rreziqe të tjera, të përbashkëta, përfshijnë mundësinë që shpjegimet e vendimeve të ndihmuara nga AI-ja mund të zbulojnë materiale komerciale të ndjeshme rreth mënyrës se si funksionojnë modelet dhe sistemet e AI-së. Për më tepër, modelet e AI-së mund të shfrytëzohen nga individë nëse dinë shumë për logjikën që qëndron pas vendimeve të tyre.

XAI ka nevojë për njerëz

Tani që kemi shqyrtuar disa nga mundësitë e XIA-s, ndikimin e tij të mundshëm në mbrojtjen e të dhënave dhe shembuj të përfitimeve, por edhe rreziqeve të tij, si mund të përparojë kjo fushë?

Për të avancuar në fushën e AI-së, bashkëpunimi njerëz-AI është i rëndësishëm. Për më tepër, bashkëpunimi ndërdisiplinor është thelbësor. Ekspertët në shkencën kompjuterike, psikologjinë konjitive, ndërveprimin njeri-kompjuter dhe etikën duhet të punojnë së bashku për të zhvilluar metodologji, standarde dhe masa mbrojtëse të forta, që promovojnë një ekosistem të drejtë të AI-së, për të fuqizuar individët, duke u dhënë atyre kontroll mbi informacionin e tyre dhe duke respektuar privatësinë e tyre. Në këtë kuptim, XAI ka më shumë gjasa të ketë sukses nëse studiuesit, ekspertët dhe praktikuesit në fushat përkatëse miratojnë, vënë në praktikë dhe përmirësojnë modelet e AI-së me njohuritë e tyre unike dhe krijuese. Mbi të gjitha, vlerësimi i këtyre modeleve duhet të fokusohet më shumë tek njerëzit sesa tek teknologjia. Siç theksohet nga Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, Wojciech Wiewiórowski, gjatë Forumit Vjetor të Privatësisë pas ngjarjes IPEN: kur bëhet fjalë për XAI dhe Inteligjencën Artificiale në përgjithësi, zbatimi i rregullave të duhura dhe rregulloreve ekzistuese të BE-së, siç është Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave. GDPR), duhet të respektohet. Mbrojtja e të drejtave themelore të individëve duhet të jetë e para. Kur përballen me sisteme të fuqishme AI, të gjitha qeniet njerëzore, madje edhe ata të zgjuarit, bëhen disi të preکشëm në lidhje me fuqinë e makinës. Prandaj, ne duhet t'i japim formë AI-së, krijesës tonë. Siç parashikohet në Pragrafin 4 të GDPR për përpunimin e të dhënave, AI duhet gjithashtu të projektohet për t'i shërbyer njerëzimit.


Leonardo CERVERA NAVAS

Por, çfarë është konkretisht AI-ja e Shpjegueshme?

Suksesi i menjëhershëm e i vrullshëm në mësimin e makinerive ka çuar në një rritje të aplikacioneve të Inteligjencës Artificiale (AI). Përparimet e vazhdueshme premtajnë të prodhojnë sisteme autonome që do të perceptojnë, mësojnë, vendosin dhe veprojnë vetë. Megjithatë, efektiviteti i këtyre sistemeve është i kufizuar nga paafëzia aktuale e makinës për të shpjeguar vendimet dhe veprimet e tyre për përdoruesit njerëzorë. Ne po përballemi me sfida që kërkojnë sisteme më inteligjente, autonome dhe simbiotike. Inteligjenca artificiale e shpjegueshme, veçanërisht mësimi i makinerive, do të jetë thelbësor nëse luftëtarët e ardhshëm do të kuptojnë, besojnë në mënyrë të përshtatshme dhe menaxhojnë në mënyrë efektive një gjeneratë në zhvillim të partnerëve të makinerive artificialisht inteligjente.

Inteligjenca artificiale e shpjegueshme, ose XAI, është një grup procesesh dhe metodash që na lejojnë të kuptojmë dhe t'u besojmë rezultateve dhe rezultateve të krijuara nga algoritmet e mësimin të makinerive. AI-ja e shpjegueshme përdoret për të përshkruar një model të AI, ndikimin e tij të pritshëm dhe paragjykimet e mundshme. Ndihej në karakterizimin e saktësisë, drejtësisë, transparencës dhe rezultateve të modelit në vendimmarrjen e fuqizuar nga AI. Inteligjenca artificiale e shpjegueshme është thelbësore për një organizatë në ndërtimin e besimit, kur vë në prodhim modelet e AI-së. Shpjegueshmëria e AI-së ndihmon gjithashtu një organizatë të adoptojë një qasje të përgjegjshme ndaj zhvillimit të AI-së.

Ndërsa AI-ja bëhet më e avancuar, njerëzit sfidohen të kuptojnë dhe të gjurmojnë se si algoritmi erdhi në një rezultat. I gjithë procesi i llogaritjes është kthyer në atë që zakonisht quhet "kuti e zezë" që është e pamundur të interpretohet. Këto modele të kutisë së zezë



krijohen drejtpërdrejt nga të dhënat. Dhe as inxhinierët apo shkencëtarët e të dhënave që krijojnë algoritmin nuk munden kuptojnë ose shpjegojnë se çfarë saktësisht po ndodh brenda tyre ose si algoritmi i AI-së arriti në një rezultat specifik.

Ka shumë përparësi për të kuptuar se si një sistem i aktivizuar me AI ka çuar në një rezultat specifik. Shpjegueshmëria mund t'i ndihmojë zhvilluesit të sigurojnë që sistemi po funksionon siç pritej, mund të jetë e nevojshme të përmbushen standardet rregullatore ose mund të jetë e rëndësishme për t'u lejuar atyre që preken nga një vendim që ta kundërshtojnë ose ndryshojnë atë rezultat.

Shqipëria, vendi i bashkëjetesës fetare, kulturore dhe vlerave historike për faqet e shtypit ushtarak, do të vijë nëpërmjet qytetit të Mirditës.

Mirdita numëronte rreth tre mijë shtëpi, kur një zonjë angleze si Edit Durhami kalonte atyre viseve të largëta:

“Të gjithë janë katolikë. Mirdita përbëhet nga pesë bajrakë, prej të cilëve Oroshi, Spaçi dhe Kushneshi janë nga i njëjti gjak me Shala-Shoshin dhe nuk martohen midis tyre as me Shalën e Shoshin.

Lekë Dukagjini ka qenë një nga të parët e tyre dhe sundonte në të gjithë malet në kohën e Skënderbeut. Lura ishte pjesë e tokave të tij. Thoshin se Skënderbeu dhe Leka ishin të lidhur mes tyre, prandaj gratë mirditore mbanin xhurdi të zezë në shenjë zie për Skënderbeun: në të gjitha fiset e tjera xhurdia mbahet vetëm nga burrat. Por nuk ekziston ndonjë gjenealogji autentike. Mirditasit nuk e rruanë kokën, siç bëjnë mjaft fise të tjera. Në shumë raste në të vërtetë ata rruanë vetëm një rrip të ngushtë të tëmthit. Meqë, dy nga pesë bajraqtë janë me gjak të ndryshëm, nuk është për t'u çuditur që tipi është mjaft i ndryshëm. Ndeshen shpesh si burra shtatgjatë me sy bojë hiri, ashtu edhe burra të shkurtër, zeshkanë, bashkë me raste kalimtare të ndërmjetme.

Udhëtarët, që i përshkruajnë gjithë mirditorët si “zeshkanë” ose “flokëverdhë”, kanë vizituar vetëm një pjesë...”.

Kjo pra ishte Mirdita e Edith Durhamit. Disa prej traditave dhe zakoneve që përshkruan aventurierja angleze në librin “Shqipëria e Epërme”, i gjen dhe pas një shekulli në zonat e Mirditës. Në kërkim të kësaj tradite të trashëguar e ruajtur brez pas brezi por dhe asaj që tashmë ka mbetur thjesht histori të çon drejt Mirditës. Pasi kalon Urën e Milotit dhe hyn në Luginën e Fanit qyteti i parë që të shfaqet pas tabelës që shënon rrethin e Mirditës është Rubiku. Kisha e të Shëlbuemit, ndërtuar në kepin e bardhë të qytetit është e para që të uron mirëseardhjen. Është ndër kishat më të vjetra dhe më të rëndësishme, e cila sipas dokumenteve daton që prej vitit 1200. Kështu Rubiku hyri në histori për kuvendin e mirënjohur, Benediktin deri në gjysmën e dytë të shekullit që lamë pas, ku emri i këtij qyteti lidhej vetëm me nxjerrjen dhe përpunimin e bakrit.

TRADITA QË SOLLËN FRANÇESKANËT QË U NGJITËN NË ATO MALE

Ndër shekuj feja ka pasur një ndikim shumë të madh tek banorët e Mirditës. Mirditasit i rregullonin tek frtërit katolikë gjithë konfliktet, jo vetëm fetare por dhe laike. Ndikimi i njerëzve me veladon është i pranishëm edhe në kulturën e gatimit.

Mirdita është një vend me histori dhe me besim të krishterë. Mirditorët janë katolikë dhe kjo reflektohet edhe në disa sjellje të tyre. Nëse kemi diçka me të cilën mund të krenohen është të qenit katolikë.

Nëse ka një kulturë të vogël kulinare në Mirditë kjo është falë frtërve françeskanë, të cilët sollën në këtë zonë jo vetëm dije e kulturë por dhe traditën e tyre të gatimit. Ndoshta ka qenë varfëria e madhe që se ka lënë të zhvillohet traditën e kulinarisë ashtu siç mund ta kenë zona të tjera të Shqipërisë. Prodhimi kryesor bujqësor i zonës është misri dhe rrushi. Misri është në bazë të shumë recetave që përgatisin gratë mirditore. Kurse rrushit i bëjnë hyzmet burrat vetëm për rakinë. Pak preferohet që rrushi të bëhet verë, përgjithësisht musht (verë e ëmbël). Blegtoria është gjithashtu shumë e zhvilluar. Racat më të mira të dhive mendohet se rriten në Fan, Velë dhe Bulgër, ndërsa lopët në Orosh, Fan dhe Spac. Derri mbetet ushqimi kryesor dhe baza e shumë prej recetave që gatuhen në Mirditë. Për “nder” të tij, mirditorët çdo prag Krishtlindjesh të shtrojnë dhe darkën e derrit, ku gatuhen të gjitha recetat, që si bazë kryesore kanë gjithçka të derrit, madje dhe gjakun e tij.

“Në çdo shtëpi në kohën kur pritet derri, i rritur gati 100 kg, gatuhen dhe recetat tradicionale me bazë gjakun dhe mishin e derrit. Në Mirditë është traditë Lakrori që gatuhet me gjakun, trutë e derrit dhe dhjamin e shkrirë ose siç thuhet në dialektin mirditor zhikrra. Receta e lakrorit me gjak është shumë e thjeshtë vetëm se ajo nuk gatuhet në çdo kohë. Koha e saj është kur pritet derri, pra në prag Krishtlindjesh. “Mishi i varur në tra gjithashtu ishte pamja më e zakonshme në kullat e dikurshme të Mirditës. Sot kjo traditë sa vjen e po zhduket ashtu si gurët e kullave që kanë humbur nën suvanë dhe gëlqeren e bardhë edhe pse lakrat e zeza me mish të thatë derri vazhdojnë të mbeten një ushqim që ende ruhet në disa zona të Mirditës.

“Shtëpi e çifteli”

Nuk mund të ketë shtëpi në Mirditë pa çifteli, skena e parë ishte oda, veçmas ajo e dasmës, ku njëri nga 11 krushqit duhej të ishte këngëtar. Njeriu i kullës në shkrep shpesh në mbrëmjet familjare, apo të kremtesh popullore, merrte çiftelinë dhe niste t'i luante gishtat dhe t'i thoshte fjalët. Nuk kishte rëndësi sa mirë dinte ta bënte ai këtë gjë, çiftelia, lahuta apo sharkia ishte pjesë e kulturës së tij të jetesës. Përndryshe malësori kishte shpirt prej artisti dhe ai e shfaqte këtë thelb të tijin herë pas here. Ndaj dhe bariu



Identiteti, vlera historike e popullit shqiptar

në mal kishte me vete fyellin dhe merrte melodi baritore njëlloj si në antikitetin ilir, grek, romak. Ai gjithë ditën e ditës pas tufave në kullotë gdhendte dhe bishta frashri për veglat e punës, dhe bilbila, zamare, me të cilat luante melodi baritore.

Bjeshkët tona janë atelieja e parë për shumë artistë të shquar të folkut, pse jo dhe për kompozitorët që i ulen motivet e bjeshkëve mbi pentagram. Mirditori krijonte melodi e muzikë gjer me kumbonët e bagëtive, ku kishte dhe një punishte të tyre prej bakri te Marlaskajt e Kuzhenit, ku kumbonët që kishin shtegtuar deri në Shkumbin tingëllojnë prej shumë vitesh në arenën artistike-folklorike të Ansambllit “Mirdita”.

Veshja mirditore

Veshja mirditore, e klasifikuar në njëzet veshjet më të bukura të rruzullit, gjendet në muzetë kryesorë të Europës, Amerikës e Rusisë, në rend me kostumet gjithë larushi të kantoneve, shteteve e kontinenteve të tjera. Vizitorët apostolikë të Vatikanit të shekullit XII e përshkruajnë gruan mirditore “të veshur në mënyrë madhështore”

Periudha e feudalizmit solli formimin e një fytyre të re të të gjitha krahinave shqiptare dhe jo vetëm Mirdita, po kjo është periudha kur krahinat filluan të formojnë identitetin e tyre. Elementet më të hershme të kostumit mirditor janë këmisha e gjatë si për burra dhe për gra dhe dollamet që ishte si një pallto e hapur me mëngët dekorative që varen.

Ka qenë një këmishë e rrudhur që krijonte imazhin e fustanellës. Kjo ka qenë veshja në fazën më të hershme. Tek gratë kemi llahengën ose xhupen.

Në veshjet e Mirditës duhet treguar një vëmendje e veçantë në pjesën e gjoksit sepse aty gjejmë një minierë. Këmisha dekorohet në mënyrën më elegante, më interesante, me një fill të hollë dhe shkëlqyes që dallohet me finesë dhe tregon fisnikëri të veçantë. Element tjetër i hershëm dhe dallues për kostumin mirditor është brezi me rrema, një brez që varet nga prapa dhe një përparje e vogël që quhet stravec. Për t'u dalluar është dekori i xhupes ose llahengës. Në të lexohet krishterimi i hershëm, i stilizuar me lloj-lloj formash, ndonjëherë të fshehta dhe ndonjëherë të hapura. Ka një simbolikë në xhuben e grave të Mirditës që ngjan sipas studiuesve të ndryshëm herë në formën e një njeriu e herë në formën e shqiponjës. Në fshatrat e Shqipërisë së Veriut përpunimi i shqiponjës është një motiv i veçantë. Shqiponja ka qenë e adhuruar dhe këtë e shohim jo vetëm në tekstile dhe veshje, por edhe në dru, është si një shpend me forcën dhe lirinë e saj që gjithnjë i ka mrekulluar shqiptarët. Ndaj është ky adhurim që ajo të përdorej gjerësisht në folklorin shqiptar. Elemente të tjera dalluese që e bëjnë të veçantë gruan mirditore është stilimi i flokëve të grave. Është e jashtëzakonshme. Mënyra e krehjes së flokëve tek gratë mirditore me të cilën tregojnë moshën dhe statusin e tyre, si dhe mënyra se si e lidhin shaminë është shumë domethënëse. Është një stil i mbretërshave të kohës, si perëndeshat e kohës ilire. E veçantë është se nuset e reja përdorin një kësulë me stringla. Në fakt ky është një element i ndikuar nga kultura të huaja lindore. Dhe kjo është normale. Ka ardhur nga emigracioni, nga fakti që Shqipëria ka qenë e pushtuar për një periudhë të gjatë nga pushtuesit e huaj dhe patjetër që kanë ndikuar dhe tregtia. Veshjet e dasmave gjithnjë kanë pasur ndikime të mëdha nga kulturat e huaja. Një gjë tjetër shumë specifike e veshjes së Mirditës janë çorapet e grave. Si në asnjë krahinë të Shqipërisë ato kanë një formë vezake. Diametri i tyre shkon 33-34 centimetra. Të gjitha zonat i kanë çorapet e ngushta, ndërsa mirditorët i kanë shumë të gjera. Madje, dhe në zonat rreth e rrotull që përdorin këtë model çorapësh i quajnë me emrin iltinka. Një gjë karakteristike e tyre janë motivet që përmbajnë. Në motivet e çorapeve gratë e krahinës derdhin gjithë krijimtarinë e tyre.

Mirdita dhe veshjen e burrave e ka shumë interesante. Edhe ajo në kohën më të hershme ka qenë e përbërë nga këmisha e gjatë dhe me një kësulë shumë të veçantë. Mirditorët dallohen nga qelshja e tyre, e cila ka një formë të prerë konike. Vetëm në shekullin 19-të burrat mirditorë filluan të mbajnë tirqe por shumë të zbukuruar me gajtanë të zi të leshtë. Më pas kemi ardhjen e jelekëve të kuq në vishnje që erdhën si ndikim nga qyteti i Shkodrës.



Më 10 qershor të vitit 1878, kur re të zeza ishin përhapur mbi qiellin e trojeve shqiptare, në qytetin e lashtë të Prizrenit u themelua organizata e parë e Lëvizjes tonë kombëtare me karakter politik panshqiptar me emrin “Lidhja Shqiptare”, ose “Lidhja e Prizrenit”. Ka hyrë në histori si një ngjarje e madhe historike, si një kthesë vendimtare në luftën për çlirim kombëtar të popullit shqiptar, e cila me rrjedhimet e saja objektive ndikoi mbi të gjitha periudhat e mëvonshme.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, zë një vend nderi në panteonin e historisë. Ajo përbën një nga momentet kulmore dhe kthesë në historinë e lëvizjes kombëtare çlirimtare shqiptare, ku mbarë populli shqiptar u hodh në rrugën e guximshme të luftës së armëve e të mendimit për të flakur tej zgjedhën e huaj, për të siguruar të drejtën e tij më të madhe për liri e tokë, për drejtësi e përparim. Ajo përbën një nga ato ngjarje që i rrëmbejnë masat me thirrjen “Ja vdekje, ja liri”, i bëjnë të marrin me vete vuajtje e flijime. Sot, kur po përkujtojmë këtë 145-vjetor të Lidhjes së Prizrenit, të gjithë shqiptarët në tërë rruzullin tokësor, me mirënjohje i japin vendin e nderit kësaj ngjarjeje kulmore dhe veprimtarëve të shquar të saj. Është krenaria jonë, se historia e kombit shqiptar është e pasur me ngjarje të tilla përparimtare. Ne krenohemi që flamuri, që ka udhëhequr popullin tonë të lashtë në rrugën e tij historike, nuk shërbeu kurrë si simbol robërimi e dhune pushtuese, as i diplomacisë së intrigave dhe kompleteve në kurriz të popujve fqinjë. Ata ishin të detyruar të përballonin rrezikun e shfarosjes e të asimilimit, të copëtimit e të grabitjes së trojeve të veta nga ana e çezarëve, perandorëve, kralëve të kohëve të lashta. Populli shqiptar i vetëm, pa aleatë, shpesh të braktisur e të tradhtuar nga klasa sunduese vendase, stërgjyshërit e gjyshërit e etërve tanë u mblodhën e u betuan për luftë në kuvendet e mëdha historike. Në vazhden e këtyre kuvendarëve të mëdhenj tradicionalë, një vend të veçantë zë Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Ajo është e vetmja organizatë politike e ngritur brenda trojeve shqiptare, që u doli zot me armë në dorë të drejtave të kombit shqiptar, një organizatë që ka jo vetëm një platformë ideologjike kombëtare e një program politik të përcaktuar qartë, por edhe një organizim shtetëror dhe ushtarak në rrafshin kombëtar për sa u takon ndarjeve krahinore e fetare të trojeve shqiptare. Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte organizata e parë politike dhe ushtarake mbarë shqiptare me frymëzim patriotik, e themeluar në Prizren, më 10 qershor 1878, në kushtet e sundimit osman dhe të Krizës Lindore, të viteve '70 të shek. XIX. Ajo mori përsipër të zgjidhte tre detyra themelore që shqetësonin në atë kohë opinionin e mbarë të shqiptarëve: a) të afirmonte në arenën ndërkombëtare kombin shqiptar, si subjekt i të drejtave kombëtare; b) të kundërshtonte copëtimin e trojeve etnike shqiptare, të vendosur në Kongresin e Berlinit (1878), në favor të monarkive fqinje ballkanike dhe c) të realizonte bashkimin e mbarë trojeve autonome në kuadër të Perandorisë Osmane, si hap i parë për të krijuar shtetin shqiptar të pavarur. Duhet theksuar se edhe para formimit të Lidhjes së Prizrenit, shqiptarët kishin zhvilluar një mori kryengritjesh kundër zgjedhës osmane, por Porta e Lartë nuk kishte pranuar asnjë nga kërkesat e tyre kombëtare. Edhe Fuqitë e Mëdha në praktikën e tyre diplomatike nuk kishin pranuar t'u njihnin shqiptarëve të drejtën e formimit të një shteti të veçantë shqiptar. As tani, kur shihej qartë fitorja ruse në luftën ruso-turke në vitet 1877-1878, asnjë nga Fuqitë e Mëdha nuk e përkrahu.

Shqetësimi i popullit shqiptar arriti kulmin me nënshkrimin, më 3 mars të vitit 1878, të Traktatit të Shën Stefanit, kur Rusia fitimtare i shkëputte Perandorisë Osmane në favor të Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi shumë terriore shqiptare.

Me ç' rast e gjymtonte rëndë tërësinë tokësore të Shqipërisë?

Kuvendi Kombëtar i Prizrenit, në të cilin morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha viseve shqiptare, zgjodhi organet e larta, Këshillin e Përgjithshëm me funksione legjislative dhe Komitetin Qendror me funksione ekzekutive.

Më 17 qershor të vitit 1878, u miratua statuti i Lidhjes Shqiptare (“Karname”) dhe “Urdhëresa” (“Talimati”), ku trajtoheshin aspektet organizative, politike dhe ushtarake të saj. Nën presionin e qarqeve patriotike, Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes, më 2 korrik të vitit 1878, miratoi një “Kanun të Ri”, i pastruar nga shprehjet për “besnikërinë ndaj Perandorisë Osmane” të Karamanësë, shënoi fitoren e plotë të Lëvizjes Kombëtare në gjirin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit kundërshtoi vendimet antishqiptare të Traktatit të Shën Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit, që preken rëndë tërësinë tokësore shqiptare në Shqipëri e bashkuar, si një vilajet i vetëm, do të kishte një status ndërkombëtar edhe pse të kufizuar, do të ishte autonome brenda territorit të vet, por e varur në marrëdhëniet me jashtë, që do të mbeteshin si më parë në kompetenca të Portës së Lartë. Megjithatë, nën sovranitetin e sulltanit Shqipëria do të gëzonte një autonomi të gjerë administrative-shtetërore, të gjitha atributet e një organizimi shtetëror, të një shteti kombëtar shqiptar. Shqipëria e bashkuar, si një vilajet i vetëm, do të kishte një status ndërkombëtar edhe pse të kufizuar, do të ishte autonome brenda territorit të vet, por e varur në marrëdhëniet me jashtë, që do të mbeteshin si më parë në kompetenca të Portës së Lartë. Megjithatë, nën sovranitetin e sulltanit, Shqipëria do të gëzonte një autonomi të gjerë administrative-shtetërore, të gjitha atributet e një organizimi shtetëror, të një shteti kombëtar shqiptar. Kërret e Lidhjes e shikonin shtetin autonom, jo vetëm si zgjidhje që mund të pranohej më lehtë nga Qeveria Osmane dhe Fuqitë e mëdha, që nuk ishin të prirura të përkrahnin shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Perandoria Osmane, por edhe si një periudhë drejtë pavarësisë



“Një komb që humbet dijen e së kaluarës, pak nga pak humbet veten”

dhe shkëputjes së plotë të Shqipërisë nga kjo perandori. Nëpër këtë rrugë patën kaluar Rumania, Serbia, Mali Zi, Bullgaria, të cilët në fillim fituan statusin e autonomisë, të shteteve vasale nën sovranitetin e sulltanit, për të kaluar më pas në shpalljen e pavarësisë së plotë.

Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit

Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit për të bashkuar shqiptarët dhe territoret e tyre në një shtet të vetëm, siç kishin bërë edhe kombet e tjera të Ballkanit dhe të Europës, nuk përbën ndonjë argument për t'iu atribuuar udhëheqësve të saj me prirje shoviniste, sikurse kanë bërë e vazhdojnë të bëjnë edhe sot historiografët e disa vendeve fqinjë. Jo për shkak të ndonjë ekskluziviteti ndërkombëtar, por për hir të kushteve në të cilat i vendosi historia, “shqiptarët, - sikurse thuhej atëherë, dhe masat e reja osmane shkaktuan një pakënaqësi të madhe në trojet Shqiptare dhe i acaruan në kulm marrëdhëniet e shqiptarëve me sunduesit osmanë”.

Në dhjetor të vitit 1880, në Kosovë filluan veprimet e armatosura kundër administratës osmane. Atdhetarët menduan se tani kishte ardhur çasti i përshtatshëm për të vënë në jetë Programin për autonomi. Në këto rrethana, ata organizuan aty nga mesi i muajit janar 1881, në Prizren, një kuvend të jashtëzakonshëm të Lidhjes Shqiptare. Në të morën pjesë vetëm përkrahësit e autonomisë. Kuvendi përjashtoi nga organet drejtuese të Lidhjes kundërshtarët e autonomisë dhe Komitetin Kombëtar e shpalli qeveri të parakohshme, kryesuar nga Ymer Prizreni (krytar), Shuaip Spahiu (nënkryetar), Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi, etj.

Qeveria e Përkohshme e Prizrenit organizoi menjëherë forcat e rregullta ushtarake dhe ngriti administratën e re shqiptare në viset që po çliroheshin. Repartet e qeverisë shqiptare, të komanduara

nga Sulejman Vokshi dhe të përkrahura nga populli, gjatë muajit janar 1881 e çliruan gjithë Kosovën, si dhe Shkupin dhe trojet e tjera shqiptare në Maqedoni.

Udhëheqësit e Lidhjes e vlerësuan kërkesën e autonomisë së Shqipërisë dhe të shkëputjes të saj në të ardhmen nga Perandoria Osmane, si “një e drejtë e popullit shqiptar për të hyrë në gjirin e familjes së madhe evropiane, së cilës i përkiste nga raca dhe gjinia”.

Në peticionin e saj të fundit, dërguar ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Stanboll, më 15 prill të vitit 1881, kur ushtria osmane e Dervish Pashës po shtypnin Lëvizjen Shqiptare, Lidhja, duke këmbëngulur në kërkesën e autonomisë, theksonte se kjo e drejtë i takon Shqipërisë, si një vend evropian. Siç theksonin konsujt e huaj, në këtë peticion shprehej synimi i Lidhjes për të ngritur në Shqipëri një administratë të tillë autonome, që të ishte e aftë të përhapte të gjitha sistemet përparimtare dhe qytetëruese të kontinentit evropian, në të cilin bënte pjesë.

Pas aksionit të Gjakovës, i cili me vrasjen e Mehmet Ali Pashë Maxharit, çoi në dështimin e përpjekjeve të Portës së Lartë, për të bindur kërret e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që t'ia dorëzonin Malit të Zi Plavën dhe Gucinë, Lidhja e Prizrenit ngriti me forcë para qeverisë osmane (Portës së Lartë) çështjen e bashkimit të të gjitha trojeve shqiptare, me një njësi më vete politiko-administrative (në një vilajet shqiptar autonom), që Porta e Lartë në mënyrë të vendosur e kundërshtoi. Vendosmëria e Lidhjes Shqiptare për të mbrojtur tokat e Çamërisë deri në lumin Kalamat e detyroi delegacionin osman në Konferencën e Prevezës, më 6 shkurt 1879, që të mos u nënshtrohej kërkesave të qeverisë greke. Lëshimet e Portës së Lartë në dëm të tërësisë territoriale të Shqipërisë, i dhanë një hov të madh lëvizjes për autonomi për krijimin e Vilajetit shqiptar, si hap i parë për fitoren

më vonë të pavarësisë së plotë. Lëvizja për autonomi, e cila e kishte shoqëruar qysh në fillim të luftës për tërësinë territoriale të Shqipërisë kishte shënuar një ngritje të re, sidomos në Kuvendin e Dytë të Frashërit (qershor 1880). Një hap i ri u bë në këtë drejtim me vendimet historike të Kuvendit të Gjirokastrës, që hartoi një program më të plotë për autonominë (24. 07. 1880). Në vijim, Kuvendi i Jashtëzakonshëm u mblodh në Prizren, në fund të vitit 1880 e Shpalli Komitetin Qendror “Kuvërnë e përdorme”.

Repartet ushtarake të saj shtinë në dorë Shkupin (4 janar), Mitrovicën (15 janar) dhe Prishtinën, më 18 janar të vitit 1881.

Nëpunësit turq u dëbuan nga të gjitha qendrat ku u vendos pushteti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.



QPR

Qendra e Personel Rekrutimit do të rekrutojë kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Turqisë, 8 (tetë) të drejta studimi.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 6 korrik 2023.

Për më shumë informacion klikoni më poshtë:
<https://www.mod.gov.al/images/njoftime2023/qpr/rekrutim-maj/20230529NJOFTIMU-D.pdf>



USHTAR / SUEL SHTALBI

BËHU VERSIONI YT MË I MIRË!

REGJISTROHU TE FORCAT E ARMATOSURA
PËR NJË KARRIERË UNIKE

REKRUTIM
FORCAT E ARMATOSURA
TË SHQIPËRISË

**NE JEMI
NATO**

APLIKO NË QENDRËN
E REKRUTIMIT TË FORCAVE
TË ARMATOSURAS
SKANO QR CODE

Ti ke forcën që nderon kombin!
Bëhu edhe ti pjesë e Forcave të Armatosura të RSH
Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 25.09.2023 - 07.12.2023, gjithsej 439 kandidatë, (426 meshkuj dhe 13 femra), sipas rajoneve përkatëse në tabelën bashkëlidhur.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 04 shtator 2023.

Për më shumë informacion klikoni më poshtë:
<https://www.mod.gov.al/images/njoftime2023/qpr/rekrutim-maj/20230529NJOFTIMU-D.pdf>